



Netherlands Enterprise Agency



KONFERENCA: PAQJA, DREJTËSIA DHE INSTITUCIONET E QENDRUESHME:



NDIKIMI I TYRE NË BARAZINË GJINORE

Proceedings Book

Artistët Krijojnë së Bashku
Qendra ACT for SOCIETY
MasterPeace Albania
Agjensia Hollandeze e Inovacionit
Instituti i Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës

Proceedings Book

ISBN 978-99-284-5641-0

KONFERENCË STUDENTORE

*“Paqja, Drejtësia dhe Institucionet e Qendrueshme:
Ndikimi i tyre në Barazinë Gjinore”*

Maj 2019

Tiranë, Shqipëri 2019

KONFERENCË STUDENTORE

Komiteti Shkencor

Prof. Dr. ILIRA SULO

Prof. Dr. MIGENA LESKOVIKU

Dr. DORIS MALAJ

PhD(c) ARMELA PENGILI - AfS

Msc. XHOI BARE

Dizenjimi Grafik

ALDORA HAJRO

Të drejtat e autorit 2019 © Qendra ACT for SOCIETY

ISSN

Publikimi

Qendra ACT for SOCIETY

Rruga "Blv. Zhanë D'ark" Nd.61, H.5, Ap.24

Tel: +355 44507447

Web: www.actforsocietycenter.org

KONFERENCË STUDENTORE

Ky publikim botohet në kuadër të Javës Europiane, ku Qendra ACT for SOCIETY nëpërmjet projektit ACT “Artistët Krijojnë së Bashku”, në bashkëpunim me MasterPeace Global dhe Institutin e Studimeve Europiane, mbështetur nga Agjensia Hollandeze e Inovacionit, organizoi konferencën studentore me temë: “Paqja, Drejtësia dhe Institucionet e Qendrueshme: Ndikimi i tyre në Barazinë Gjinore”.

Në kuadër të 17 Objektivave të Qendrueshme të OKB-së: 16 Ndikimit të Paqes, Drejtësisë dhe Institucioneve dhe 4 Edukimit, në promovimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave.

Përmbajtja

1. Barazia Gjinore dhe Qeverisja Vendore në kuadër të Zhvillimit të Qendrueshëm.....	5
<i>Admir Hoxha, student MSH</i>	
2. Roli i Paqes, Drejtësisë dhe Institucioneve të Forta në fuqizimin e bashkëpunimit qeveri-biznes – akademi.....	12
<i>Aida Lahi, doktorante, UT</i>	
3. Siguria dhe Gjinia në Marrëdhëniet Ndërkombëtare.....	17
<i>Armela Pengili, doktorante, UT</i>	
4. Trajtimi i figurës së Sevasti Qiriazit në kontekstin e emancipimit të gruas shqiptare.....	30
<i>Bertina Salliu, studente MSH</i>	
5. Paqja, drejtësia, institucionet e forta dhe barazia gjinore, si faktorë për zhvillimin e shoqërisë.....	36
<i>Brunilda Malkollari, studente MSH</i>	
6. Të drejtat e njeriut në Europë dhe mbrojtja e tyre. Mosdiskriminimi si një nga parimet bazë në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore.....	42
<i>Dorian Leskoviku, doktorant, UT</i>	
7. Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe impakti i saj në Barazinë Gjinore.....	49
<i>Marinela Bogdani, studente MSH</i>	
8. Rëndësia e barazisë gjinore dhe roli i saj si faktor stabiliteti.....	54
<i>Oltian Gorezi, student MSH</i>	
<i>Denada Seferi, studente MSH</i>	

BARAZIA GJINORE DHE QEVERISJA VENDORE NË KUADËR TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Admir Hoxha, Student MSH

Përmbledhje

Barazia gjinore, është kusht për një shoqëri të drejtë, të qëndrueshme e socio-ekonomikisht të zhvilluar. Një fjali që shpreh më së miri se cdo të thotë kushte normale që të garantojë zhvillimin e qëndrueshëm në një shoqëri. Nëse do të analizonim të kundërtën për një moment do të mernim të mirqënë se barazia gjinore është kusht për një shoqëri të shtrembërt, jo të qëndrueshme e socio-ekonomikisht të pazhvilluar. Dhe për të garantuar këtë të fundit kushti më minimal është që në qeverisjen lokale të jenë të angazhaur 0 % femra dhe 100% meshkuj. Mendoni për një moment sikur kjo shifër të ishte dicka e zakonshme. Ky zhvillimi i qëndrueshëm që e propagandojme në kuader të objektivave të tij do të ishte në rrezik serioz, pra shoqëria do të ishte në rrezik. Mendojmë për një moment sikur femrat të mos egzistonin fare. Do të kishte dy zgjidhje: ose ne njerëzit do të shumoheshim me kafshët dhe me fokat në Arktik. Zgjidhja tjetër për ne meshkujt do të ishte se do të shumoheshim me njëri tjetrin. Pra shoqëria nuk do të egzistonte fare si e tillë. Kjo mund të ngjajë si deklaratë seksiste sepse përfundimi i saj nxjerr në pah rolin e femrave në ripërtëritjen biologjike. Kjo është maja e ajsbergut e rolit të femrave në shoqëri. Statistikat e mëposhtme që do të sjell, nxjerrin në pah këtë rol dhe gjendjen në qeverisjen lokale që egziston dhe prej saj jemi në gjendje të bëjmë një vlerësim sa e rrezikuar është shoqëria shqiptare drejt vazhdimit të rrugës për një zhvillim të qëndrueshëm dhe premisat e të ardhmes.

Fjalët kyçe: Barazi gjinore, qeverisje vendore, zhvillim i qëndrueshëm, mbrojtje sociale

- **Qeverisja e mire është barazi gjinore**

Kur studiojmë gjendjen e qeverisjes lokale dhe barazinë gjinore këto të dyja nuk mund ti kuptojmë pa i garantuar arsimin fillor të gjithë djemëve dhe vajzave, sepse eliminimi i pabarazisë në nivelin fillestar të arsimimit zbut dhe ul ndjeshëm pabarazinë në të ardhmen sepse brezat edukohen me frymën e barazisë, drejtësisë, bashkpunimit, tolerances etj. Sipas qendrës së Aleancës Gjinore për Zhvillim, mentaliteti familjar që femrat duhet ta braktisin shkollën ndikon 9 herë më shumë se te meshkujt. Barazia gjinore është një betejë që duhet luftuar në disa fusha të ndryshme përndryshe mbetet e njëanshme dhe jo efektive. Duke qene se periudha e tranzicionit ka ndikuar negativisht dhe në integrimin e gruas në tregun e punës dhe pjesëmarrja e gruas në vendimmarrje ka rënë në mënyrë të konsiderueshme dhe mbetet më e ulëta në krahasim me vendet e tjera të Evropës Lindore dhe Qendrore. Të shumtë janë faktorët si zhvillimi i ngadaltë ekonomik, mentalitetet egzistuese të trashëguara, pritshmeritë e shoqërisë për gratë dhe shumë i rëndësishëm vullneti politik për të përfshirë gratë në vendimmarrje. Ne vitin 2002 përqindja e grave në parlamentin shqiptar ishte e krahasueshme me atë të vitit 1945 që tregon se periudha e tranzicionit ka ndikuar negativisht. Por

cila është zgjidhja më e mirë për përmirsimin e kësaj situatë dhe afrimit të një situatë ideale në barazinë gjinore??

Përqëndrimi te brezi i ri, sidomos te ai që studion shkencë politike, për të rritur angazhimin e tyre vecanërisht në fushatat zgjedhore si një përvojë e vyer politike për karrierën në të ardhmen si politik-bërës/e.

Autoritetet vendore përfaqësojnë nivelet më afër njerzëve dhe kështu janë në pozita më të mira për të trajtuar drejtpërdrejt pabarazinë dhe për të nxitur mënyra qeverisje që synojnë një respektim të vërtetë të barazisë gjinore.

Të drejtat e grave dhe burrave janë të rrënjësura në aktin ligjor më të lartë të Shqipërisë, në Kushtetutën e Shqipërisë. Neni 18 garanton barazi të grave dhe burrave para ligjit. Shqipëria ka ratifikuar Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) më 1993. Dy ligje të tjera që rregullojnë posaçërisht barazinë gjinore në Shqipëri janë: ligji 10221 “për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe ligji 9669 Për masat kundër dhunës në marrdhëniet familjare¹

Nëse duam të krijojmë një shoqëri të bazuar në barazi, është thelbësore që qeverisja vendore ta marrë në konsideratë dimensionin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikën e tyre. Dhe në botën e sotme dhe në atë të nesërme, barazia e vërtetë e grave dhe burrave është gjithashtu çelësi për suksesin tonë ekonomik dhe social- jo vetëm në nivel evropian dhe kombëtar por edhe në rajonet, qytetet dhe komunitetet tona lokale.

Qëllimi kryesor i rritjes së pjesëmarrjes së grave në politikë nuk është thjesht rritja e numrit të grave në këtë sektor, por përkrahja e krijimit të një axhende të re dhe demokratike në politikë, e cila do të ndryshojë për mirë jetën e të gjithëve, të burrave dhe grave. Lesley Abdela²

Nuk mund të flitet për pjesëmarrje të gruas në politikë në mënyrë të shkëputur, pa folur për pjesëmarrje të gruas në jetën ekonomike, sociale, pa folur për dhunën ndaj grave etj. Në të njëjtën kohë nuk mund të jetë i suksesshem trajnimi i problemeve të grave dhe vajzave, si pjesë e shkëputur e programeve qeverisëse, por si pjesë e këtyre programeve Për shkak të mendësive patriarkale që mesa duket vazhdon akoma, jo vetëm tek populli por edhe të përfaqësuesit politikë, shumë gra dhe vajza nuk i njohin të drejtat e tyre dhe nënvlerësojnë faktin që ato zotërojnë potenciale, që i duhet politikës dhe jo vetëm, por zhvillimit të mëtejshëm të këtij vendi.

Pra është e rëndësishme që kur flasim për pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në politikë, si një kusht për demokracinë, por në të njëjtën kohë të punojmë edhe për ndërgjegjësimin e shumë grave dhe vajzave për të drejtat, potencialet dhe aftësitë e tyre. Jo rastësisht ekziston thënia; “Nëse do të vlerësohesh demokracinë e një vendi, përparimin e një shteti dhe civilizimin e një shoqërie, shiko se çfarë vendi ka grua në të”.

Gratë që merren sot me politikë, kanë vështirësi në punën e tyre, sepse shpesh herë janë quajtur “zëdhënës të burrave”. Të mbeshtesim gratë për të pasur më shumë akses në vendimmarrje nuk është një privilegj që ato e kërkojnë por dicka që ato e meritojnë.

¹ Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore dhe plan i veprimit 2016-2020, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, fq 77-80.

² Barazia Gjinore si kusht për integrimin evropian, fq 33-40, Valdete Sala, 2014.

Shumë shpesh, vendimet për pozicionet e drejtuesve në parti apo pozicionet e kandidatëve nëpër lista, kryhet në mënyre informale pas dyersh të mbyllura prej burrave që tradicionalisht zotërojnë monopolin e forcës.

Paradoksi që vihet re në Shqipëri është se: Kur nje grua vepron në mënyrë autokratike, për atë thuhet shpesh se po “vepron si një burrë” dhe e vlerësojmë pak kur flasim për cilesitë për të udhëhequr. Ndërsa kur ato udhëhiqen nga konsensusi, atëherë ka komente të kundërta që nënvizojnë se gruaja nuk mund të mbajë dot një qëndrim të fortë³. Një parlamentar anglez ka thënë: *“Femra nuk është inferiore ndaj burrit, por as superiore ndaj tij, ndërsa për barazi nuk bëhet fjalë”*⁴.

Në korrik të vitit 2008 u miratua “Ligji për barazinë gjinore” i cili vendosi për herë të parë kuoten gjinore, si një detyrim ligjor për të garantuar pjesëmarrjen mbi 30% të seciles gjini në organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor në institucionet e tjera publike⁵. Sipas këtij ligji, por edhe duke ju referuar përvojës botërore, partitë politike konsiderohen si subjekte kryesore për të garantuar balancën gjinore në organet vendimarrëse në nivel qendror dhe vendor.

Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në nivel vendor e qendror është shumë e rëndësishme, por balanca gjinore në vendimarrjen lokale merr një rëndësi të vecantë për shumë arsye. Proçesi i decentralizimit shtron nevojën që politikën në nivel qendror tju përgjigjen më mirë nevojave të komunitetit përfshirë këtu gra dhe burra, të rinj dhe të moshuar. Gratë, në përgjithësi, janë më pranë dhe kanë më shumë përvojë në trajtimin e çështjeve që lidhen me arsimin, shëndetësinë dhe shërbimet sociale. Gruaja dhe burri janë të ndryshëm, por jo aq shumë sa njëra kategori të jetë përpara e tjetra pas. Barazia gjinore përshkruan konceptin sipas të cilit të gjitha qëniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e personalitetit të tyre dhe të bëjnë zgjedhje pa kufizime të vendosura nga stereotipat, rolet e ngurta gjinore apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë se sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave konsiderohen, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Ajo nuk do të thotë se gratë dhe burrat duhet të bëhen njëloj, por se të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse janë lindur femra apo meshkuj.

Të investosh tek gratë është jo vetëm gjëja e drejtë që duhet bërë. Është edhe gjëja me e mençur që duhet bërë. Unë jam thellësisht i bindur se gratë përbëjnë potencialin më të rëndësishëm, por edhe më të pashfrytëzuar për zhvillim dhe paqe, që bota ka në dispozicion”. Ban Ki Moon, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, mars 2008⁶


³ Testament i grave për gratë, fq 79, Zenepe Luka, 2017.

⁴ Si të përmiresojmë zhvillimin në nivel vendor? Manual nga praktikant më të mira nga Evropa Juglindore, fq 55-57, Hamlet Bezhani, 2012


⁵ Karta Evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, fq 17, Majlinda Nishku, 2015

⁶ Fuqizimi i gruas në vendimarrjen lokale, Shoqata: Unë, gruaja, 2011.

Akses më i madh i grave në demokracine lokale dhe Pjesëmarrja më e madhe grave në vendimmarrje



Investim më i madh në kapitalin njerëzor të fëmijëve të tyre



Përmirësim i produktivitetit të brezit të ardhshëm të punonjësve

Të dhënat e para në lidhje me përbërjen e Parlamentit të Shqipërisë vijnë nga legjislacioni i vitit 1920. Gjatë kësaj periudhe Parlamenti i Shqipërisë është përbërë vetëm nga burra. Pasi gratë në Shqipëri morën të drejtën e votës, anëtarët e para gra në Parlament u zgjedhën në legjislacionin e vitit 1945, duke zënë një peshë prej 7%. Shkalla e pjesëmarrjes së grave në Parlamentin Shqiptar ka qënë konstante gjatë legjislacioneve të 1997, 2001 dhe 2005 nën nivelin 10%. Përmirësimi i ndjeshëm i rritjes së grave anëtare në Parlamentin e Shqipërisë u bë i mundur pas përfshirjes së kuotës 30% në ndryshimet e kodit elektoral, në vitin 2008. Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2009, pjesëmarrja e grave në parlament u rrit me më shumë se dyfish, nga 7 në 16%. Tendenca në rritje vihet re edhe në zgjedhjet parlamentare 2013, ku arriti në 18%. Nga viti 2013 deri në vitin 2017, tendenca në rritje e numrit të grave dhe vajzave në parlament ka vazhduar si efekt i zëvendësimit të burrave deputetë me gra deputete, si pasojë e lënies së mandateve. Si rezultat i këtij zëvendësimi në vitin 2017, ka 29% gra, anëtare në Parlament. Ndër tetë komisionet parlamentare, pjesëmarrja më e madhe e grave është në “Komisionin për punën, çështjet sociale dhe shëndetësinë” dhe Komisioni për politikën e jashtme, me rreth 50%⁷.

Ndryshimet në kodin elektoral bënë të mundur që të përmirësohet ndjeshëm përfaqësimi gjinor edhe në organet e qeverisjes vendore. Në përbërje të listave me kandidatë në zgjedhjet për kryetar bashkie të vitit 2015, kishte 10% gra. Kandidatët/et fitues për kryetar bashkie ishin 15% gra dhe kjo përqindje mbetet e tillë edhe sipas vlerësimit në dhjetor 2017. Përbërja e listave në zgjedhjet për Këshillat Bashkiakë në vitin 2015, ishte 49% gra. Përqindja e grave ndër kandidatët fitues në zgjedhjet vendore të atij viti ishte 35%, ndërsa sipas vlerësimit të bërë në dhjetor 2017, përqindja e grave ndërmjet këshilltarëve të bashkive është 36,9 %.

⁷ INSTAT, 2018

Të dhëna gjinore për kandidimin në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore për Këshillin Bashkiak, 2015

The Gender data for candidature in elections to local government bodies for the Municipal Council, 2015

Zgjedhjet vendore, 2015	Numër - Number		%		Local Elections, 2015
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
Kandidatë për Kryetar Bashkie	142	16	90	10	Candidates for Mayor of Municipality
Fitues Kryetar Bashkie	52	9	85	15	Winning Mayor of Municipality
Kryetarë Bashkie dhjetor 2017	52	9	85	15	Mayor of Municipality december 2017
Kandidatë për Këshillat Bashkiak	18.404	17.937	51	49	Candidates for Municipal Councils
Fitues Këshilltarë Winning Advisor	1.040	555	65	35	Winning Advisor
Këshilltarë Bashkie dhjetor 2017	1.006	589	63	36,9	Advisor of Municipality december 2017

Burimi: Instat

Qeveritë vendore janë aktorët kyç në bërjen e proceseve qeverisëse më të barabarta, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse. Dhe, një qeverisje që është më e barabartë, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse, është në fund më efektive dhe efikase! Harmonizimi i gjinisë - instrumenti zyrtar për të arritur barazinë mes grave dhe burrave - kërkon që të gjitha politikat, programet dhe proceset të marrin në konsideratë ndikimin e tyre të mundshëm të ndryshëm mbi burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat. Kjo ndodh ngaqë idetë tona për rolet, përgjegjësitë dhe cilësitë e ndryshme të grave dhe burrave, që janë specifike për secilin dhe për çdo kulturë, do të thotë që gratë dhe burrat kanë akses dhe kontroll të ndryshëm - dhe të pabarabartë - te vendimmarrja, burimet, informacioni, shërbimet dhe programet brenda familjeve dhe komuniteteve. Në botën e sotme dhe në atë nesërme, barazia e vërtetë e grave dhe burrave është gjithashtu çelësi për suksesin tonë ekonomik dhe social - jo vetëm në nivel evropian dhe kombëtar, por dhe në rajonet, qytetet dhe komunitetet tona lokale⁸.

- **Shpjegimi klasik kulturor-psikologjik i ndryshimeve gjinore**

Shpjegimi për ndryshimet gjinore, kulturore, mund të burojë nga tezat socio-biologjike. Ato nisen nga preferenca dhe sjellja tipike gjinore të predispozura gjenetiksht, të cilat kanë lindur gjatë evolucionit të njeriut. Pra ndryshimet gjinore vijnë si rezultat i selektimit natyror të ndryshëm gjatë evolucionit të njeriut, i cili ka pasur tek femrat dhe meshkujt efekte të ndryshme⁹.

Një zgjidhje efikase për përmirësimin e qeverisjes vendore është dhe ajo e angazhimit të liderit vendor të cilët janë në kontakt ditor me banorët e zonave. Ato shërbejnë si forca shtytëse për organizimin e aktiviteteve të ndryshme. Kombinimi më i mirë është kur liderët vendor menaxhojnë edhe modele të suksesshme biznesi, për arsye se ata janë shembujt më të mirë për të motivuar komunitetin.

⁸ Shteti i së drejtës dhe qeverisja vendore, fq 268-270, Xhezair Zaganjori, 2011.

⁹ Roli udhëheqës; shtatë portrete në qeverisjen vendore, fq 105-104, George Clack, 2013.

Sipas një studimi të institutit për studime politike për 22 këshilltarët më aktiv të qarkut Tiranë, nga një shikim i thjeshtë më rezulton se 54% e më aktivëve ishin meshkuj dhe 46% ishin femra¹⁰.

Po sipas këtij instituti në zgjedhjet 2015 u aplikua për herë të parë kuota gjinore e kandidimit 50% me 50% për në këshillat bashkiakë. Pavarësisht kuotës 50% të kandidimit për këshilla në përfundim rezultuan 35% gra e vajza të zgjedhura në këshilla. Diferenca midis dy shifrave duket shpjeguar nga sistemi i votimit në proporcional, ku sa më shumë parti politike të fitojnë aq më pak shanse ka respektimi i kuotës së barabartë gjinore, pasi shumica e partive të vogla kandidojnë me lista me në krye kandidatë meshkuj. Asnjë prej partive politike konkurruese në zgjedhje nuk drejtohet nga grua/ vajzë, megjithatë, ndryshe nga viti 2011 dhe 2013, për herë të parë të gjitha partitë politike konkurruese ia arritën të realizojnë dhe paraqesin lista kandidimi në proporcional të bazuara në raportet e balancimit gjinor, 50% me 50%. Ndryshimi pozitiv i dedikohet shumë më tepër ndryshimeve në Kodin Zgjedhor dhe forcimin e masës penalizuese për partitë që shkelin ligjin në aspektin e kandidimit gjinor, sesa vullnetit politik dhe interesit elektoral të vetë partive politike. Në 16 bashki kandiduan gra/vajza për postin e kryetares së bashkisë, 9 prej tyre fituan¹¹.

Në bashkinë Shkodër dy nga tre kandidatët ishin gra, në Selenisë kandidoi një grua si e vetmja kandidaturë e pavarur për kryetar. Në bashki si Pogradeci gruaja kandidate humbi garën, por përqindja e grave dhe vajzave në këshill është rekord zgjedhor, kurse në bashki si Gjirokastra me gjithë rënien drastike të pjesëmarrjes së grave e vajzave dhe votuesve në tërësi në zgjedhje, një grua arriti të zgjidhej kryebashkiake. Në total 14% e bashkive do të drejtohen nga gra/vajza, rezultat dukshëm dhe shumëfish më i lartë sesa më 2011 dhe 2007. Në total 31% e grave kandidate për këshillat bashkiakë arritën të fitojnë, ose 35% e numrit total të fituesve këshilltarë, në dy rastet shifër shumë më e lartë sesa 2011 dhe 2007¹².

Sipas Roswith Roth në botimin e saj për studimet psikologjike gjinore ajo thot se: “Asimetria themelore mes dy gjinive është se një burrë, teorikisht mund të bëjë më shumë fëmijë sesa është në gjendje të lind një grua e vetme. Për meshkujt ka rëndësi sasia (shumë fëmijë me shumë gra), ndërsa për femrat ka rëndësi cilësia (pak fëmijë dhe përkujdesje intensive për to¹³”. Duke ndjekur këtë llogjikë mund të them se gratë janë më të dobishme në qeverisjen lokale, pasi ato gjenetikisht janë më afër problemeve të komunitetit nga prirja e tyre për ti bërë gjërat në mënyrë cilësore. Po në të njëjtin botim autorja sjell një shembull të një eksperimenti. Kryetarja e bashkisë së qytetit të Eutin në Schleswig Holstein i ka nxitur pjestarët e këshillit bashkiak që për 14 ditë të përdornin vetëm format femërore të emërimit të profesionit të tyre. Këto rregulla u mbajtën në mënyrë strikte dhe cfarë ndodhi më mbas? Pjestarët meshkuj shprehën dëshirën urgjente që të ktheheshin përsëri format mashkullore, duke thënë se që tani ata do të ishin të gatshëm të përdornin dhe format femërore¹⁴. Ata thanë se nuk kishin arritur të identifikoheshin me termat femërore, edhe kuptuan sa e rëndësishme ishte për gratë të emëroheshin dhe të perceptoheshin ashtu sic ju takon, si një grup me përgjegjësi, ashtu sic ato janë në fund të fundit.

¹⁰ Instituti i studimeve politike, Afrim Krasniqi, fq 22-24, 2018

¹¹ Po aty, fq 26-28

¹² Po aty, fq 33-35

¹³ Hyrje në studimet psikologjike gjinore, 2015, fq 88-90, Roswith Roth

¹⁴ Po aty, fq 92.

Referencat

- 1- Karta Evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, Majlinda Nishku
- 2- Si të përmiresojmë zhvillimin në nivel vendor? Manual nga praktikantët më të mirë nga Evropa Juglindore, Hamlet Bezhani
- 3- Testament i grave për gratë, Zenepe Luka.
- 4- Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore dhe plan i veprimit 2016-2020, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.
- 5- Hyrje në studimet psikologjike gjinore, Roswith Roth
- 6- Instat
- 7- Shteti i së drejtës dhe qeverisja vendore, Xhezair Zaganjori.
- 8- Fuqizimi i gruas në vendimarrjen lokale, Shoqata: Unë, gruaja.
- 9- Barazia Gjinore si kusht për integrimin evropian, Valdete Sala
- 10- Roli udhëheqës; shtatë portrete në qeverisjen vendore, George Clack.
- 11- Instituti i studimeve politike, Afrim Krasniqi, 2018

ROLI I PAQES, DREJTËSISË DHE INSTITUCIONEVE TË FORTA NË FUQIZIMIN E BASHKËPUNIMIT QEVERI-BIZNES – AKADEMI

Aida Lahi, doktorante

Përmbledhje

Në shtator të vitit 2015 Asambleja e OKB miratoi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, i cili është konsideruar si projekti më ambicioz në historinë e njerëzimit. Kjo iniciativë ka në thelb adresimin e sfidave më urgjente në zhvillimet komplekse, me të cilat bota përballlet sot. Këto Objektiva janë një version modern i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, miratuar nga OKB në vitin 2000 dhe kanë një shtrirje kohore deri në 2030.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm krijojnë mundësinë e zbatimit të një plani të jashtëzakonshëm të zhvillimit social e ekonomik në mbarë botën, të cilat përfshijnë një kosto kolosale shpenzimesh të llogaritura prej trilionatë dollarësh dhe me një angazhim prej miliona njerëzish të punësuar për t'i përmbushur ato.

Megjithatë, krahas të gjitha këtyre përpjekjeve të organizatave ndërkombëtare dhe qeverive të vendeve anëtare të OKB-së, nga eksperte të çështjeve ndërkombëtare sugjerohet të merret në konsideratë një aspekt shumë i rëndësishëm, i cili ofron një zgjidhje më efektive në përmbushjen e objektivave globale dhe ai lidhet me instalimin e një koordinimi dhe renditje prioritare në të tre nivelet – qeveri, sektori privat dhe akademi.

Një ndër 17 Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm dhe të të gjithë zhvillimit aktual global është sigurisht “Paqja, Drejtësia dhe Institucionet e Forta”. Roli i këtij Objektivi është i patjetërsueshëm si në zhvillimin social ashtu edhe në atë ekonomik të vendit. Prandaj investimi që ka nevojë të bëjë Shqipëria në këtë Objektiv, në kushtet aktuale, ku ambicia kryesore është integrimi në Bashkimin Europian, është jo vetëm i duhur por edhe i domosdoshëm.

Fjalët kyçe: Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, bashkëpunimi qeveri – biznes – akademi, paqja, drejtësia.

- **Hyrje**

Asambleja e Kryetarëve të Kombeve të Bashkuara u mbledh në Nju Jork në vitin 2000 dhe miratoi Deklaratën e Mijëvjeçarit, duke angazhuar vendet përkatëse në një partneritet të ri global, i cili kishte në thelb uljen e varfërisë ekstreme në të gjitha dimensionet e saj (Saad, M., & Zawdie, G.,

2008). Kjo deklaratë përmbante tetë objektiva të zhvillimit, me afat zbatimi vitin 2015, të cilat njihen gjerësisht si Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM).

Ndonëse vendet nënshkruese e morën me shumë seriozitet dhe bënë një progres të dukshëm në angazhimin e tyre për t'i përmbushur këto objektiva, disa prej tyre nuk u arritën. Prandaj u konsiderua e nevojshme që të mendohej një axhendë e cila shkonte përtej këtij afati kohor (2015). Në këto kushte, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, miratoi më 25 shtator 2015 axhendën e zhvillimit të periudhës pas 2015, duke bërë një planifikim të objektivave për 15 vitet e mëpasshme.

Ky angazhim rezultoi në përgatitjen e një Axhende të re, e cila përcakton të shtatëmbëdhjetë Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZHQ), të shtrira në një afat kohor nga 2015 deri në 2030. Axhenda e re tashmë përmbante jo vetëm plotësimin e atyre objektivave që nuk ishin arritur gjatë fazës së parë të këtij projekti gjigand, por përfshinte edhe objektiva të reja me shtrirje globale siç ishte paqja, drejtësia dhe institucionet e forta. Kjo lidhej ngushtësisht me faktin se këto problematika kanë sinergji të pandashme me disa probleme kryesore globale, duke patur në të njëjtën kohë ndikim në të gjitha aktivitetet njerëzore. Dhe pikërisht për këtë arsye të tre këtyre komponenteve i është përcaktuar një objektiv i posaçëm, OZHQ nr. 16. (Pathfinders for Peaceful, 2017). Ky objektiv i veçantë është i domosdoshëm që të ketë një qasje gjithëpërfshirëse jo vetëm në trajtimin, por edhe adresimin e problemeve globale që lidhen drejtpërdrejt me paqen, drejtësinë dhe rrjedhimisht edhe me institucionet e forta (PWC, 2015).

Në krahasim me OZHM-të, OZHQ-të janë përgjithësisht më bashkëpunuese në shkallë globale, por edhe në partneritete të brendshme. Për shembull, sektori privat është i përfshirë në mënyrë më aktive nëpërmjet iniciativave të ndryshme siç është ajo e UN Global Compact and Impact 2030. Gjithashtu, ajo që vërehet tek OZHQ-të, është se, në krahasim me OZHM-të, ato janë projektuar për të integruar akoma më mirë parimet dhe standardet e të drejtave të njeriut. Kjo është edhe arsyeja pse ato janë më gjithëpërfshirëse se OZHM-të.

Në kuadrin e angazhimit të shumë vendeve, edhe Shqipëria i miratoi OZHQ-të në shtator të vitit 2015, paralelisht me të gjitha shtetet e tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara. Pak muaj më vonë, në fillim të vitit 2016, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë miratoi edhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHI II), e cila kishte një shtrirje kohore 2015-2020. Ky angazhim tregon që Shqipëria vazhdon ta ketë objektiv kryesor jo vetëm integrimin evropian, i cili është kthyer tashmë në një shtytës kryesor reformash, por edhe Programin e Bashkëpunimit Për Zhvillim të Qëndrueshëm (PBZhQ) të Kombeve të Bashkuara, duke i dhënë bashkëpunimit ndërkombëtar një përparësi të përbashkët politike.

Por, nga ana tjetër kostoja e këtij angazhimi nuk është e vogël. Pas kësaj përfshirjeje qëndrojnë dhe vështirësitë (Persson, A., Weitz, N. Nilsson, M., 2016). Brenda këtyre objektivave, qëndrojnë 169 nën-objektiva, zbatimi i të cilave në rrafsh global do të kërkojë një kosto prej rreth 45 trilionë dollarë (Supiot A., 2015). Janë vetë ekspertët dhe akademikët ndërkombëtarë, të cilët theksojnë se

mundësia që shpenzimet të kryhen në mënyrë të pakoordinuar dhe, si rrjedhim, jo efikase është e madhe (UNDP, 2015). Kjo për faktin sepse vetë objektivat janë të pa konsoliduara dhe rrjedhimisht nuk është shumë e qartë se si qeveritë e vendeve përkatëse do të ndërmarrin hapa të integruar që do të lehtësonin ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm.

Madje, gjatë përpilimit të 169 synimeve (nën-objektivave) kishte diskutime të gjata dhe shumë ekspertë sugjerorin “pastrimin” e listës së nën-objektivave dhe reduktimin e tyre në 117 të tillë, duke synuar një platformë më të thjeshtëzuar, e cila do të përshpejtonte zbatimin e suksesshëm të listës.

Ndryshimi i dytë thelbësor ndërmjet OZHM-ve dhe OZHQ-ve lidhet me normat dhe udhëzimet për politikat fiskale dhe rregullatorët që nxisin investimet private, si mënyrë për të përmirësuar cilësinë e jetës në tërësi. Investimet private mund të jenë edhe shumë fitimprurëse, por gjithsesi fati i tyre varet nga performanca e ekonomisë kombëtare. OZHQ-të janë të bazuara në konceptin se: biznesi investon kapitalet e tij në zgjidhje, të cilat krijojnë vlera reale për shoqërinë, dhe si rrjedhim ai do të përfitojë shumë nga stabiliteti i ardhshëm si dhe zgjerimi ekonomik - jo vetëm në vendin përkatës, por edhe me gjerë. Në këtë qasje, fati i zbatimit të OZHQ-ve varet shumë nga mirë përcaktimi i prioritetëve kombëtare si dhe nga qartësia që qeveritë përkatëse duhet të kenë vizion në hapat që ndërmarrin (Kirkland, J., 2005). Kjo lidhet direkt në përgatitjen e platformave kombëtare ashtu dhe në ngritjen e strukturave përkatëse zbatuese për të bërë të mundur partneritete të cilat në eksperiencat e vendeve më të zhvilluara kanë rezultuar shumë të suksesshme siç është partneriteti qeveri – biznes – akademi, i quajtur ndryshe në literaturën shkencore si modeli i Heliksit të Trefishtë (Etzkowitz, H., & Leydesdorff, L., 2000).

- **Roli i partneritetit qeveri – biznes - akademi në OZHQ 16: Paqja, Drejtësia dhe Institucionet e Forta**

Ndërkohë që pas më shumë se tre vitesh negociata intensive, u ra dakord për axhendën ambicioze dhe transformuese për Zhvillim të Qëndrueshëm të arritshëm në vitin 2030 në nivel global, Shqipëria ashtu si dhe shumë vende të tjera përballet me sfidën që t’i trajtojë dimensionet ekonomike, sociale, mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm në një mënyrë të integruar.

Duke qene se objektivat dhe synimet kanë për qëllim zhdukjen e varfërisë ekstreme, luftën ndaj pabarazisë, fuqizimin ekonomik të vajzave dhe grave, mbrojtjen e burimeve natyrore, përmirësimin e nivelit të qeverisjes, inkurajimin e një rritjeje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike si dhe përqendrimin e përpjekjeve kolektive për mundësi të barabarta për të gjithë, ato do të stimulojnë veprimin dhe zhvillimin për dhjetë vitet e ardhshëm në këto fusha me rëndësi themelore.

Për Shqipërinë, Axhenda 2030 do të shërbejë gjithashtu si një pikënisje për një angazhim të ri, për një program zhvillimi, i cili është më ambicioz në një sërë fushash, duke harmonizuar kështu angazhimet europiane me nevojën për ta çuar vendin në nivelin e vendeve të zhvilluara.

Për Shqipërinë dhe përpjekjet e saj në integrimin europian, qëndrueshmëri do të thotë forcimi i shtetit të së drejtës si dhe i vlerave demokratike shoqërore. Reforma transformuese në drejtësi e bashkërenduar me një klimë të mirë biznesi dhe si dhe me investime të shëndosha në ekonominë e dijes është procesi më i qëndrueshëm që do ta bashkojë më shumë shtetin me qytetarët, do t'i japë sistemit të drejtësisë kuptimin e tij, do të ketë një ndikim më të thellë dhe pozitiv në progresin e vendit.

Në kontekstin empirik, një platformë bashkëpunimi mes qeverisë, sektorit privat dhe akademisë në fushën e anti-korrupsionit është iniciativa ABC, e cila i referohet krijimit të Koalicionit të Biznesit për Anti-korrupsionin. Pjesëmarrësit e kësaj platforme janë përfaqësues nga institucionet publike, organizatave të biznesit si dhe përfaqësues nga academia. Duke bashkëvepruar në një model të Heliksit të Trefishtë, kjo platformë synon të sjellë në vëmendje angazhimin e këtyre tre grupeve në çështjet që kanë të bëjnë me sjelljen e përgjegjshme të biznesit. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e qeverisë zotohen që të përfshijnë parime dhe standarde ndërkombëtare për një sjellje ndaj biznesit në fusha të tilla si: marrëdhëniet e punës dhe industriale, të drejtat e njeriut, mjedisi, dhënia e informacionit, lufta ndaj korrupsionit, interesat e konsumatorit, shkenca dhe teknologjia si dhe konkurrenca dhe taksimi.

Qëllimi final i kësaj iniciative është përmirësimi i klimës së biznesit në Shqipëri përmes institucioneve të forta, aktivizimit të instrumenteve të duhura dhe ndërmarrjes së veprimeve të qëndrueshme nga të gjitha palët.

• Konkluzione

Për të përmbushur detyrimet që i vijnë Shqipërisë nga nënshkrimi i marrëveshjes për miratimin e OZHQ-ve si dhe për të lehtësuar ri-dimensionimin e suksesshëm të këtyre objektivave në kuadrin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, është e nevojshme zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, si dhe mundësimi i platformave të bashkëpunimit ndërmjet qeverisë, sektorit privat dhe akademisë.

Nëqoftëse fokusohemi tek njeri nga këto 17 objektiva, si në rastin konkret tek OZHQ 16, i cili ka në fokus paqen, drejtësinë dhe institucionet e forta, shihet e nevojshme ndërtimi i mekanizmave konkretë të bashkëpunimit mes sferës së sektorit privat me dy sferat e tjera: ajo e sektorit të administratës publike si dhe ajo e akademisë.

Së fundmi, orientimi i këtyre platformave drejt llogaridhënies dhe mirëqeverisjes siguron një ndërthurje të brendshme edhe me 16 OZHQ-të e tjera dhe në thelb krijon bazat e një zhvillimi të qëndrueshëm, kaq të nevojshëm si një shtet i vogël në veçanti, por edhe në kontekstin global.

Referencat

Etzkowitz, H., & Leydesdorff, L. (2000). “The dynamics of innovation: from National Systems and „Mode2“ to aTriple Helix of university–industry–government relations”, *Research Policy*, Vol.29, fq.109–123;

Kirkland, J. (2005). “University research management: Towards a global profession”, *International Journal of Technology Management and Sustainable Development*, Vol. 4, No. 1, fq.63-65;

Pathfinders for Peaceful, (2017), Just and Inclusive Societies, “The Roadmap for Peaceful, Just and Inclusive Societies – A Call to Action”;

Persson, A., Weitz, N. Nilsson, M. (2016), “Follow-up and Review of the Sustainable Development Goals: Alignment vs. Internalization”, *Review of European Comparative & International Environmental Law*, 25, fq. 59-68;

PWC (2015), “Make it your business: Engaging with the Sustainable Development Goals”;

Saad, M., & Zawdie, G. (2008) “Triple helix in developing countries – issues and challenges, *Technology Analysis & Strategic Management*”, Vol. 20, No. 6, fq.649-652;

Supiot A. (2015), “Governance by Numbers: The Making of a Legal Model of Allegiance”, Oxford: Hart Publishing;

UNDP (2015), “Goal 16 - The indicators we want; Virtual Network Sourcebook on Measuring Peace, Justice and Effective Institutions”, New York: UNDP.

SIGURIA DHE GJINIA NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Armela Pengili, doktorante, UT

Përmbledhje

Në këtë punim do të shqyrtoj çështjet e gjinisë dhe sigurisë por, për të kuptuar më mirë punimin sigurisht do të filloj me një kuptim të shpjegimit të gjinisë, arsyet përse dhe mënyrën sesi gjinia merr rëndësi qëndrore për një kuptim më të plotë të sigurisë.

Vërehet se kohët e fundit specialistët e Marrëdhënieve Ndërkombëtare kanë filluar të hulumtojnë reagimet e ndryshme të burrave dhe grave ndaj politikave shtetërore mbi sigurinë, konfliktin dhe luftën. Nëpërmjet këtij punimi do të kuptojmë më mirë nocionet gjinore dhe vendosjen e tyre në qëndër të debateve mbi çështjet e sigurisë, ku besoj se do të shpjegohen një sërë kuptimesh të koklavitura mbi lidhjen e njerëzve që i përkasin secilës gjini, lidhur me frikën, pasigurinë dhunën me institucionet e luftës dhe të paqes.

Gjinia dhe siguria janë dy koncepte që na ftojnë në kundërshti politike të pafundme. Përballja me to, e shumëfishon në mënyrë të pashmangshme këtë tipar. Gjithësesi përballja nuk është arbitrare dhe kompleksiteti që prodhon nuk është një tipar i pashmangshëm i përpjekjes për të kuptuar marrëdhëniet mes tyre.

Fjalë kyçe: Gjinia; Siguri; Marrëdhënie Ndërkombëtare; Luftë; Paqe

• Hyrje

Gjinia dhe siguria janë dy koncepte të cilat na ftojnë në kundërshti politike të pafundme, sidomos në rastin kur ne diskutojmë dhe mundohemi ti shpjegojmë dhe të gjejmë një tipar ose rëndësi të përbashkët. Prandaj përballja me to e shumëfishon në mënyrë të pashmangshme tiparin kundërshtar. Gjithësesi përballja nuk është arbitrare dhe kompleksiteti që prodhon nuk është një tipar i pashmangshëm i përpjekjes për të kuptuar marrëdhëniet mes tyre. Nëpërmjet këtij punimi do të mundohem të nxjerr në pah rëndësinë e shqyrtimit të përbashkët të gjinisë dhe sigurisë duke shqyrtuar dy vizione në conceptualizmin e tyre të përbashkët. Pavarësisht faktit evident se të kuptuarit e gjinisë ose sigurisë do të ketë nevojë për të dyja këndvështrimet, është e dobishme të bëhet dallimi midis aspekteve që këtu do t'i quajmë “praktike” dhe “diskursive” të marrëdhënies midis gjinisë dhe sigurisë. Aspektet praktike thjeshtëzohen nga roli konkret i grave në forcat e armatosura, ose si viktimat, spektatore ose ndihmëse të konfliktit ushtarak ose të militarizmit në

përgjithësi. Aspektet diskursive thjeshtezohen nga marrëdhëniet midis *militarizmit* dhe *mashkullorësisë*, ose edukimit dhe *feminitetit*.

Kur vëmë re këtë dallim e lidhim me dy zhvillime të tjera, ku secila prej tyre përforcon, megjithëse në mënyra komplekse dhe të paparashikueshme, marrëdhënien reciproke midis gjinisë dhe sigurisë. Zhvillimi i *parë* përfshin promovimin e një koncepti më të gjerë sigurie që ka qënë tradicional. Për të përshkruar këtë proces janë përdorur një sërë termash, midis të cilëve janë “*siguria njerëzore*” ose “*siguria e butë*”. Kjo përfshin një zhvendosje relative të fokusit tradicional mbi çështjet ushtarake brenda sigurisë, me pasoja në aspektet praktike dhe ligjëruese të marrëdhënies gjini-siguri. Proçesi i *dytë* konsiston në pozicionimin dhe operimin në ushtri¹⁵ të gjinisë femërore. Literatura feministe na ndërgjegjëson në lidhje me një sërë pasojash të politikave të sigurisë së shtetit mbi gratë. E para është paraqitja e faktit se lufta mund të ketë dhe pasoja specifike gjinore. Dhe kjo jo se gratë kishin gjasa të ishin viktime indirekte të luftës, por se politika e luftës mund të targetonte në mënyrë specifike gratë në terma përdhunimesh gjenocidiale ose abuzimi seksual. Siç e kemi parë dhe gjatë luftimeve të Ballkanit vlerat që u bashkangjiten grave mund t’i bëjnë ato të prekshme ndaj sulmeve të abuzimit. Vërejmë ndërkohë disa vuajtje të tjera të shkaktuara mbi gratë për sa u takon zhvendosjeve ekonomike dhe sociale pas konfliktit. Një trajtë më pozitive të gratë është se ato mund të vetorganizohen për të protestuar kundër politikës shtetërore dhe disa tipareve të nacionalizmit.

Shkrimtarët dhe historianët feministë na paralajmërojnë vazhdimisht për mënyrën se si shtetet janë përpjekur historikisht të kontrollojnë biologjinë e grave për të ndërtuar politika të caktuara shtetërore. Simbolet femërore të shtetësisë ishin dhe vazhdojnë të mbeten një karakteristikë e shumë shteteve.

Do të zbulojmë se ndoshta tipari më i spikatur i literaturës së kohëve të fundit është se “gjinia” është një mënyrë për të zbuluar shqetësimet e sigurisë që na lejojnë të shohim se gjinia, si kategori më vete, është një konstrukt social. Pra mënyra se si veprojnë ose reagojnë burrat dhe gratë mund të jetë produkt i ndryshimit seksual, por mund të jetë produkt i rrethanave të caktuara. Natyrshëm, shtrojmë pyetjen se si lidhen, në kontekste të ndryshme, burrat dhe gratë në aparatin lokal, rajonal dhe ndërkombëtar të sigurisë. A është e vertetë që politikat e sigurisë, siç kanë pretenduar disa feministë, privilegjojnë gjithnjë burrat dhe diskriminojnë përherë gratë? Apo mos ndoshta duhet të kuptojmë se burrat nuk janë gjithnjë ose thjeshtë liderë, luftëtarë dhe shtypës të grave?

Siguria dhe gjinia janë terma që, për t’i kuptuar siç duhet, kërkojnë të lidhen mes tyre. Kjo nuk do të thotë që çdonjëri mund të thjeshtëzohet karshi tjetrit. Sigurisht, kjo nuk do të thotë që kanë dhe role të pavarura nga njëri-tjetri. Gjinia – në të gjitha format dhe me të gjitha ndërlikimet e saj – ndikon dhe në shumë aspekte të tjera, përtej sigurisë; dhe nga ana tjetër siguria – sido që ta konceptojmë varet nga shumë gjëra të tjera përveç gjinisë. Përpjekja për të kuptuar secilin term më vete, pa vlerësuar rolin e tjetrit, prodhon një konceptim të varfëruar të të dyve. Sigurisht, të

¹⁵ Shih (Kennedy-Pipe dhe Welch 2001), për të kritikuar “feminizimin” e detyrave ushtarake, ku tregohet se besueshmëria u bë e madhe në vitin 2001, tendencë e cila përfshin intensifikimin e vazhdueshëm të teknologjisë së luftës duke prodhuar në mënyrë hipotetike saktësi më të lartë, kontroll në largësi dhe luftë virtuale.

kuptuarit e sigurisë dhe gjinisë nuk çon në ndonjë ndryshim në praktikë, por mund të ngrerë një hipotezë që dominon çdo politikë të arsyeshme dhe që duhet të bëjë një hap të parë.

- **Ide ligjëruese**

Një prej prirjeve më të rëndësishme në teorinë bashkëkohore të Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka qenë rritja e njohjes dhe pranimi të rolit të atyre që në përgjithësi i quajmë “ide” në jetën politike ndërkombëtare. Shtetet, tradicionalisht dhe në përputhje me linjat realiste të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, e kanë renditur sigurinë e tyre kombëtare si prioritet. Në emër të sigurisë kombëtare shpesh herë janë justifikuar buxhetet e mëdha në mbrojtje, prodhimi i armëve bërthamore, rekrutimi ushtarak i popullsisë mashkullore (me raste dhe asaj femërore), pushtimet dhe ndërhyrjet e huaja si dhe dhunimi i të drejtave të brendëshme civile. Siguria e shtetit preceptohet si një detyrë fundamentale e qeverisë dhe si një detyrim që duhet të mbështetet prej shumicës, për të mos thënë prej të gjithë qytetarëve. Shëmbull: Ngjarjet e 7 korrikut të vitit 2005, kur katër kamikazë vranë 52 qytetarë dhe u plagosën rreth 700 të tjerë pas një sulmi në një nga metrot e Londrës, treguan qartë se në Britaninë e Madhe jo të gjithë qytetarët ndanin të njëjtin konceptim për sa i takon detyrimin ndaj shtetit. Duhet theksuar se, besnikëria ndaj shtetit është shfaqur dukshëm në periudha lufte dhe në kohë emergjencash kombëtare. Për shumicën e shteteve garantimi i sigurisë kombëtare ka qenë dhe vazhdon të jetë një privilegj thuajse eksklusiv i meshkujve. Por shumë gra mbështesin dhe pranojnë që konsiderohen si thirrje legjitime për veprim ushtarak shtetëror, detyra kryesore e përcaktimit dhe e mbrojtjes së sigurisë së shtetit është parë si detyrë e burrave. Vlen për tu theksuar se kjo kompetencë e meshkujve është bazuar në shumë mënyra në punën, kuptimin dhe shfrytëzimin e atij grupi social të njohur si gra.

Historikisht lufta dhe beteja luftarake kanë pëfaqësuar aspiratat më të larta të anëtarëve meshkuj të elitave politike, sociale dhe kulturore, përgjatë kohës dhe në aspektin kulturor. Në këtë kohë, shërbimi ushtarak i atdheut të një individi është parë për shumë kohë si simbol nderi¹⁶. Shumë mendojnë se lufta është ende e lidhur me vlerat maskiliste si fuqia fizike, nderi dhe kuraja. Në shoqëri të caktuara, ata burra që nuk duan ose nuk mund të luftojnë klasifikohen si “gra”: madje detyrohen të veshin fustane si shenjë e dobësisë së tyre. Stërvitja ushtarake ka synuar gjithnjë dhe vazhdon ende të përforcojë nocione të caktuara të mashkullorësisë.

Misogjinizmi (urrejtja për femrat) mund të jetë një komponent i dobishëm: meshkujt mund të nxiten të shtypin gjithçka që konsiderohet femërore dhe, për rrjedhojë, një atribut që nuk i ka hije një ushtari. Sakrifikimi i jetës së një individi në luftë për të mbrojtur vendin e tij është parë si forma më e lartë e patriotizmit, por dështimi dhe paaftësia për të luftuar është një akt i ulët dhe burracak, ose një provë e ndonjë dobësie fizike apo mendore që e kantandis mashkullin më pak se ç’duhet të jetë. Po ashtu të mohosh besnikërinë ndaj shtetit ose ta lëndosh atë, si në rastin e sulmit me bomba vetëvrasëse në Britani në vitin 2005, do të thotë të vësh në pikëpyetje vetë thelbin e asaj çka ne konsiderojmë detyrë të një qytetari.

¹⁶ Të vdesësh për vendin tënd është një ndjesi e ëmbël dhe e duhur (shih Owen, Wilfred (1995), “the Collected War Problems”, New York: Norton).

Në ndryshim nga burrat, gratë janë parë prej shumë kohësh si përkujdesëset dhe edukueset e më të rinjve. Në shumë përshkrime të luftës, gratë kanë zënë vend vetëm në sferën private të ngarkuara me mbrojtjen e një aspekti të gjithëpranishëm të jetës kombëtare- frontit të brendshëm. Kjo nënkupton që gratë, madje dhe në gjendje lufte, nuk u larguan praktikisht kurrë prej shtëpisë¹⁷. Ky polarizim midis gjinive është përshkruar nga Elsthain (1987) kështu: “Gratë janë përjashtuar nga diskutimet rreth luftës, kurse burrat janë përjashtuar nga diskutimet rreth fëmijëve”. Megjithatë gratë, pavarësisht të përshkruara historikisht si “përkujdesëse”, ato janë paraqitur shpeshherë edhe si “plaçkë lufte”, preceptim ky i cili historikisht ka qenë në përputhje me statusin ligjor të grave: ato shiheshin si pronë e mashkullit. Përdhunimi konsiderohej si dëmtim i pronës së mashkullit dhe jo i vetë grave. Nga përdhunimi i grave Sabine¹⁸ në mitologjinë greke deri në vlerësimet për abuzim seksual dhe gjymtimin e grave gjatë luftimeve ballkanike të viteve 1990-të, akti i përdhunimit ka qenë një tipar i zakonshëm në pasqyrimin dhe realitetet e luftimeve. Duhet theksuar se studiuesit e feminizmit vetëm në fund të viteve '90-të i kushtuan vëmendje eksperiencave femërore gjatë luftës. Kjo fushë deri asokohe nuk ishte debatuar dhe nuk ishte konsideruar qendrore në asnjë debat rreth Marrëdhënieve Ndërkombëtare¹⁹.

Falë punës së studiuesve si Anthony Beevor²⁰, tanimë ne njohim përdorimin e rëndomtë të përdhunimit nga ushtarët e Ushtrisë së Kuqe gjatë avancimit dhe pushtimit të qyteteve gjermane në pranverën e vitit 1945. Studiuesit kanë shqyrtuar kohëve të fundit përdorimin e përdhunimit si një taktikë e supozuar lufte nga ushtarët serbë dhe ata kroatë gjatë konfliktit në Kosovë. Më së fundi jemi informuar për rrëfimet e poshtërimit seksual të kryer nga ushtarët amerikanë ndaj robërve irakianë të luftës. është interesant fakti se na është bërë e ditur se në të tilla sjellje është përzier edhe personeli femëror i shërbimit, që ka sfiduar nocionet e feminizmit, duke nxjerrë në pah brutalitetin që marrin gratë në pozita pushteti relativ.

Disa studiues meshkuj, ndoshta me qëllime polemike, i kanë përshkruar gratë si shkaktare të luftimeve dhe kanë nxjerrë në dukje rastet në të cilat gratë kanë nxitur burrat e tyre në betejë²¹. Në përgjithësi, pavarësisht karakterizimeve të mëvonshme roli i femrës në luftë, por dhe jashtë saj është i qartë. Siç e ka thënë dhe Nitchze në një formulim të mirënjohur, ndonëse tashmë një formulim tashmë i mërzitshëm: “Burri duhet të stërvitet për luftë dhe gratë për çlodhjen dhe argëtimin e luftëtarit: gjithçka tjetër është marrëzi”.²² Këto përfaqësime të grave dhe të luftës janë

¹⁷ (shih Sherry, Michael S. (1995) “In the Shadow of War. The United States since the 1930s,” New Haven, CT: Yale University Press).

¹⁸ Sabine- emër i pjesëtarëve të një popullsie të vjetër në Apeninet Verilindore

¹⁹ (shih Nicarchos, 1995), sipas tij përdhunimi i grave gjatë dhe pas luftës është i mirë-dokumentuar sikurse edhe shembujt kur përdhunimi duket se është përdorur si një “taktikë” luftimi për të poshtëruar ose demoralizuar armikun.

²⁰ Beevor, Antony (2002), “Berlin: The Downfall 1945”, London: Penguin.

²¹ Pasqyrimi deri diku i mjegullt i vajzave që shtrëngojnë pendë në duart e atyre djelmoshave që ngurrojnë të dalin vullnetarë për të shërbyer në ushtri gjatë Luftës së Parë Botërore ballafaqohet me krijesat gjysmë- mitike të cilat, sipas Martin Van Crevald, zbulonin gjokset e tyre për të nxitur luftëtarët të trimëroheshin në betejë (shih Van Crevald, 2001).

²² (shih Hollingdale, R.J (1977), London)

të rëndësishme për shkak të lidhjes midis luftës, burrërisë dhe shtetit modern, një lidhje të cilën shumë aktorë të botës moderne nuk e kanë për turp ta pranojnë.²³

Në disa kultura atributet mashkullore janë shpërblyer tradicionalisht me përparim social ose mbajtjen e posteve të larta politike. Në shoqërinë izralite, si dhe në një sërë shoqërish të tjera, shërbimi ushtarak siguron një standart burrërie. Thelbi i feminizmit vazhdon të shihet ende si i përmbushur nëpërmjet martesës me një hero-një njeri i cili ka shërbyer në ushtri. Kjo u atribuon grave, qoftë edhe në një shtet si Izraeli, që ka prioritet sigurinë, një rol pasiv, atë të gruas ose të së dashurës së një heroi.

Historitë e shteteve ndërtohen zakonisht në terma tepër gjinorë. Ndërsa kombet në ditët tona mund të grumbullojnë mbështetje për skuadrat (meshkujve) e futbollit apo regbisë, tradicionalisht, në brendësi të shumë shteteve, identitetet bashkohen rreth narracioneve të historive ose celebrimit të luftimeve të pavarësisë apo çlirimit kombëtar. Shumë levizje nacionaliste kanë përdorur një larmi përfytyrimesh gjinore që inkurajojnë burrat për të luftuar për atdheun dhe mbrojtjen e një vendi: mbrojtja e një brezi toke amë përshkruhet në to në terma femërorë.²⁴

Historitë kolektive, si ato që kemi parë në Irlandën e Veriut²⁵, kanë rëndësi qendrore për mënyrën në të cilën shumë individë dhe komunitete vetëpërcaktohen si qytetarë si dhe mënyrën në të cilën elitat politike prodhojnë mbështetje për vendimet e politikës së jashtme, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me luftën. Rrallëherë memorie të tilla kolektive përmbajnë heroina, megjithëse dikujt mund t'i kalojë nëpër mend Zhan D'Ark.

Sipas studiuesve feministë, lidhja e mashkullit me luftën i ka privilegjuar detyrimisht burrat. Kjo ndodh për shkak të mënyrës sipas së cilës shërbimi ushtarak, sidomos gjatë viteve të Luftës së Ftohtë, dhe konceptimeve të sigurisë kombëtare e asaj bërthamore vlerësoheshin në terma mashkullorë. Natyra gjinore e shtetit është e rëndësishme dhe domethënëse për pabarazitë e trajtimit të grave brenda shoqërisë në përgjithësi. Barazia për gratë mund të arrihet pikësepari duke krijuar shanse të barabarta në arsim, nëpër institucione sociale dhe në vendet e punës dhe, më pas nëpërmjet arritjes graduale të barazisë së përfaqësimit në zyrat qendrore të shtetit: Brenda qeverisë, gjyqësorit dhe, sigurisht ushtrisë. Argumenti këtu mbetet i thjeshtë: burrat kanë “kapur” shtetin, prandaj gratë duhet ta rimarin atë.

• Shembuj realë

²³ Çështje e vërteta, Dixon citon gjeneralin Adna Chaffe kr thotë: “ Nëse lufta pushon, kombi do të zhburrërohet dhe femërzohet” (shih Dixon, 1976). Shteti modern u lind nga lufta dhe u konsolidua përmes saj, siç ka pohuar Charles Tilly në shprehjen e tij të famshme: “ Lufta bëri shtetin dhe shteti bëri luftën” (shih Tilly,1989).

²⁴ Shih Edwards, 1999; Kështu: “Nena Rusi”, “Mariana” në France apo Statuja e Lirisë në Amerikë janë simbole të fuqishme të shpirtit të një kombi. Himnet kombëtare janë shpeshherë këngë luftërash, kurse festat kombëtare mund të celebren në disa vende apo kultura me marshime ushtarake ose paraushtarake, në të cilat pjesëmarrësit janë zakonisht burra.

²⁵ Është shokues fakti se si, edhe një vend postkonfliktual si Irlanda e Veriut, paradat e përvitshme nëpër rrugët e provincës dominohen nga burrat dhe udhëhiqen medoemos nga ata liderë meshkuj që dëshirojnë të forcojnë një version të caktuar të asaj çka do të thotë të jesh britanik ose irlandez.

Eksperienca në betejë vazhdon të mbetet edhe në epokën bashkëkohore një mënyrë për të fituar poste të larta ose, në një shtet si Amerika, një mënyrë për të siguruar zgjedhjen politike, këto ide sigurisht mbështeten nga shumë studiuse femra. Ashtu sikurse qytetërimet e lashta dhe ato mesjetare i kushtonin respekt të veçantë qytetarëve që ishin sprovuar në luftë, edhe sot e kësaj dite një veteran lufte mund të bëhet objekt i një respekti të veçantë. Ky është një nder që u mohohet në përgjithësi grave. Tradicionalisht gratë janë konsideruar të papërshtatshme për të mbajtur poste të larta në strukturat ushtarake ose në ato që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare. Nëse rrallëherë, gratë do të ishin luftëtare, ato gjithashtu kishin pak gjasa të ishin shefa të CIAs apo të komandës ajrore strategjike. Nëse në kohët e vjetra ishin burrat që udhëhiqnin ushtritë, janë ende ata që në shumicën dërrmuese të rasteve vazhdojnë të mbajnë postet e shefave ushtarakë, atyre të shërbimeve informative dhe të industrive bërthamore. Megjithatë gratë janë përdorur tradicionalisht si spiune, agjente speciale ose në njësi speciale informative (shih Steans, 1998). Nuk është e nevojshme të vëmë në dukje se ky lloj përdorimi mund t'i përshtatet më së miri pikëpamjeve tradicionale gjinore të grave si ndoshta dinake, dhëlpërake dhe të afta t'i mashtrojnë burrat me anë të përdorimit të favoreve seksuale.

Por, në shtetet e Bashkuara duket se ekzistojnë pengesa më të mëdha për gratë politikanë, madje dhe për politikanët meshkuj, që kërkojnë poste por që nuk kanë shërbyer në ushtri²⁶.

Ish generalët shihen si më të mundshëm për poste presidenciale dhe disa politikanë amerikanë kanë kandiduar për këtë post bazuar në shërbimin e mëparshëm ushtarak. (për shembull: Senatori John Kerry argumentonte se eksperiencia e tij në Vietnam shërbeu për ta bërë atë të përshtatshëm për të udhëhequr).

Sidoqoftë, duhet kontestuar çdo pikëpamje pozitive rreth mënyrës se si janë trajtuar burrat pasi i shërbyen vendit të tyre në luftë. Veteranët e luftës së Vietnamit, sidomos ata që i përkisnin komunitetit autokton afrikan të Sheteve të Bashkuara, vështirë se do të pranojnë që trajtimi i tyre ishte si heronj, apo të besojnë se eksperiencat e tyre në luftë i ndihmuan ata të përparojnë në shoqërinë amerikane (shih Sherry, 1995).

Pavarësisht provave në rritje të haraçit që individit duhet të paguante për të qenë ushtar, të vdesësh në luftë për vendin tënd shihej më së paku, sipas narracioneve të caktuara të luftës, si nder -madje ishte një nder ndaj të cilit përuleshin brenda shumë kulturave. Ndërtimi i një gjëndjeje sigurie mashkullore nuk është aksidental. Siç thekson Cynthia Enloe, "vazhdimësia e militarizmit nuk është ruajtur thjesht duke u bazuar në një lloj mashkullorësie civile...por ajo kërkon rreshterë të stërvitur...dhe vullnetin e burrave për të fituar kredencialet e burrërisë së tyre duke shërbyer si ushtarë. Ajo kërkon gjithashtu që gratë të pranojnë hipoteza të caktuara rreth përkujdesjes prej nëne, martesës dhe punës së pakualifikuar, apo të politikave, qofshin ato të shkruara apo të pashkruara, për të garantuar lloje të caktuara marrëdhëniesh midis gjinive" (shih Enloe, 1993). Formulimi i saj është i rëndësishëm pasi shpjegon nëpërmjet argumentave përse, ndonëse gratë

²⁶ Elshten dhe Tobias, Sheila (1990), "Women, Militarism and War.

janë integruar gjatë pesëdhjetë viteve të fundit në shumë institucione të shtetit, ushtria dhe çështja e luftës kanë mbetur më së shumti kompetencë e meshkujve.

Në Shtetet e Bashkuara dhe në vendet e NATO-s, ndërsa është rritur lëvizja e grave, kërkesat janë përshkallëzuar nga çështja e përfshirjes së grave në ushtri, deri në insistim për të drejtën e pjesëmarrjes në betejë. Disa grupe feministe pretendojnë se pjesëmarrja në betejë do të promovojë e forcojë më tej pozitën e grave në një kuptim të përgjithshëm. Në 1966 në Shtetet e Bashkuara u themelua Organizata Kombëtare për Gratë (OKG). qëllimi i së cilës ishte promovimi i grave në jetën publike. Një pikë tjetër e fushatës së kësaj organizate ka qenë dhe mbështetja e “të drejtës për të luftuar”. Ata që inkurajojnë lejin e grave në betejë kanë argumentuar se, përveç çështjes së të drejtave politike, meshkujt që shërbejnë në ushtrinë amerikane gëzojnë një sërë përfitimesh ekonomike, si përkujdesje shendetësore falas apo kredi me kushte të favorshme, të cilat u mohohen grave.

Zyrtarë amerikanë kanë frikë se gratë anëtare të OKG-së në kushte robërie mund t’i nënshtrohen vërtetë sulmeve seksuale ose të dhunimit. Këtu shtohen çështje: A mund gratë realisht të luftojnë? A mund t’i mbijetojnë ato kapjes rob? Ose një pyetje akoma dhe më cinike: a ia vlente ndoshta që për jetën e një ushtarëje të re, të bëhet një shpenzim aq i madh kohor sa ai për qindra ushtarë meshkuj të vrarë? Po këtu vjen dhe faqja tjetër, ku mund të përgjigjem fare shkurt. – Jeta e mijërave grave irakiane, afgane etj, të vrara plagosura apo të lënduara nga këto luftra; veç gjendjes së tyre të mjerua i është kushtuar pak vëmendje. Këtu qëndron dhe paradoksi, mu në zemër të mënyrës moderne, të quajtur liberale, të luftës. Sipas këtij paradoksi, gratë perendimore janë tepër të “vyera” për t’u lejuar të marrin pjesë në betejë ose në zonat e rrezikshme të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, kurse gratë jo-perendimore janë të pavlera në politikën ndërkombëtare.

Megjithatë, çështja e femrës ushtarake mund të jetë një tejzgjatje e thjeshtë e të drejtave dhe, sigurisht, e detyrimeve. Nëse gratë janë pjesëtare me të drejta të plota në shoqëri, atëherë atyre u duhet atribuar dhe një detyrë respektive për të përmbushur detyrimet që kërkon shteti. Derisa gratë të konsiderohen të përshtatshme për shërbimin ushtarak, ato do të vazhdojnë të jenë të përjashtuara jo vetëm nga postet më të larta të shërbimeve të armatosura, por edhe nga barazia e plotë brenda shoqërisë.

• Biologjia dhe Siguria si kontradita

Për shumë individë gratë shihen si seksi “i dobët” dhe kështu, ato do të vazhdojnë të jenë qytetarë të dorës së dytë, të varura nga burrat për mbrojtjen e tyre si në mjedisin ndërkombëtar ashtu dhe në kontekstin e brendshëm. Në shumë shoqëri bashkëkohore shteti ka rekrutuar burrat e rinj për të shërbyer në forcat e armatosura, duke përjashtuar zakonisht gratë. Si rrjedhojë, efekti i përgjithshëm i kësaj politike është “armatosja” e burrave dhe “çarματοςja” e grave. Sipas studiuesve feministë, përjashtimi i femrave nga thirrja nën armë ka pasoja të rëndësishme: njëra prej tyre është varësia nga burrat për mbrojtjen e tyre. Kthimi i grave në shtëpi kur bie errësira është një metaforë e nevojës që kanë femrat për një protektor për të mbijetuar jashtë dhe përtej sigurisë së hamendësuar së shtëpisë dhe vatrës familjare. Për këtë arsye feministët që njohin dhe

pranojnë kërcënimin që u kanoset grave (madje edhe burrave) nga dhuna në rrugë, flasin më shumë për nevojën e “tërheqjes së natës” sesa për kërkimin e një “heroi” që do shoqërojë një grua në shtëpi.

Sigurisht që në nivel shtetëror ekzistojnë disa arsye pragmatiste për këtë. Në fund të fundit, masakrat e grave në fushën e betejës përkrah burrave do të shkatërronin brezat e ardhshëm. Shprehja “gratë dhe fëmijët” përdoret zakonisht për të simbolizuar rolin e femrës brenda komunitetit, ajo përmend një rol të nënshtruar, duke i lidhur gratë me “vasalët” e tyre. Ky është një vend i rëndësishëm për shkak të biologjisë dhe të kërkesave të vazhdueshme të shtetit për elementët e tij femëror që lindin fëmijët e kombit. Për shkak të biologjisë së tyre gratë janë përdorur për të promovuar qëllime specifike të sigurisë. Kështu, ka qenë dhe kërkesa për tu shumëzuar, sepse ashtu e donte interesi kombëtar apo dhe ai perandorak. Megjithatë ky mund të duket një formulim tepër i vrazhdë, ai ka rëndësi jetike për të kuptuar mënyrën se si shtetet dhe shoqëritë e pasluftës riprodhojnë popullsinë e tyre dhe mbijetojnë. Jo më kot Stalini, por dhe shteti ynë Komunist atëherë, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, kërkoi një rritje të numrit të lindjeve. Gratë në popullsinë ruse u inkurajuan të kishin një numër të lartë fëmijësh, sepse shteti sovjetik po përpiqej të rilindte nga shfarrosja e popullsisë së tij gjatë viteve të luftës (shih Kennedy-Pipe dhe Welch 2004). Në shtete të caktuara grave u mohojë akses në kontrollin e lindjeve, ose në abort për të promovuar dhe arritur një nivel të caktuar riprodhimi.²⁷ Aktiviteti human më intim për gratë ishte më pak i rëndësishëm, sesa kërkesat e elitave mashkullore politike dhe fetare që gratë të kryenin një shërbim funksional dhe biologjik për shtetin. Ky rol i grave si riprodhuese mbetet imperativ për shëndetin e shumë shoqërive të pasura dhe të industrializuara. Shqetësimi i autoriteteve franceze në vitin 2004 mbi tendencat e ardhshme demografike ishte i tillë sa që i detyroi ata t’u jepnin mbështetje financiare të paguara nga shteti grave që lindnin më tepër se një fëmijë. Problemi mbetet i njohur për disa kombe: gratë duhet të binden ose detyrohen të lindin fëmijë, sipas tekave të autoriteteve qëndrore (rasti i Kinës).

• Gratë si viktima

Ne jetojmë në kohën e ushtrive profesionale, ky besim tek gratë mund të mos shkaktojë një krizë në përgatitjen e forcave ushtarake, ndonëse mund të ngrejë çështje të sigurisë së butë të natyrës demografike, balancave etnike dhe profileve të moshës. Në të vërtetë, mbrojtja e grupit, e grave, që mund të garantojë të ardhmen e shtetit ose të komunitetit nëpërmjet biologjisë së tij, ka kuptim në mënyra të caktuara. Gjithsesi, fjala e atyre që mbrohen mund të ketë pak rëndësi për sa i takon mënyrës se si atyre u garantohet “siguria” nga shteti apo institucionet ushtarake që luftojnë në emër të tyre. Në të vërtetë, studimet e fundit mbi mënyrën e trajtimit të grave para dhe pas luftës tregojnë marrëdhënien disi të dykuptimtë që ekziston midis forcave të armatosura dhe grave civile. Ndërsa gratë kanë qenë shpesh herë objektiva të dhunës nga armiku në konflikt, ka gjithashtu raste në të cilat ato mund të vuajnë në duart e të ashtëquajturve “protektorë” të tyre. Kështu për shembull, raportet nga Afrika paraqesin prova brutale nga trupat paqeruajtëse kundër grave

²⁷ Buckley, Mary (1989), “Women and Ideology in the Soviet Union”, London.

lokale.²⁸ Kjo mund të forcojë në fakt argumentin e grave ushtare për t'u angazhuar në disa detyra të caktuara paqeruajtëse, si dhe për t'u përdorur veçanërisht në situata postkonfliktuale, megjithëse ekuacioni midis paqeruajtjes femërore bazohet në një interpretim të caktuar të ushtares femër dhe në një këndvështrim dashamirës që eksperiencat nga lufta mund të kenë ose jo mbi ushtarët.

Studimet, që analizojnë Luftërat ballkanike në fillim të viteve 90'të dhe Luftën e Parë të Gjirit, kanë treguar një nivel të lartë dhune ushtuar mbi gratë nga ushtarët e kthyer në shtëpi prej traumës së konflikteve. Prandaj mund të ngrihet pretendimi se dhuna kundër grave është më dominuese në shoqëritë e militarizuara, por dhe brenda familjeve ushtarake dhe se duhet rishqyrtuar ideja që gratë dhe fëmijët janë të mbrojtur nga ushtarët meshkuj.²⁹

- **Roli i gruas si paqedashëse**

Historia njerëzore provon që gratë dhe paqja janë të ndërlidhura. Femrat si mbartëse të fëmijëve, janë detyrimisht më shumë kundër luftës sesa burrat. Si rregull, këto lëvizje kundër luftës e kanë trajtuar aparatin ushtarak të shtetit, veçanërisht komponentin e tij bërthamor, si shprehje të agresionit mashkullor. Brenda kësaj çështje nënat janë afirmuese të jetës dhe biologjia e qënies femërore nuk pranon militarizmin mashkullor. Ndërsa gratë e “paqes” të viteve 1980-të mund të pretendojnë jo pa të drejtë se influencuan në fakt debatin ushtarak përmes veprimeve të tyre –si “lidhja me pranga dhe zinxhirë nëpër muret rrethues të bazave bërthamore, vallëzimi mbi siluetat e raketave dhe hedhja brenda vargut të xhipsave ndërsa kalonin në rrugë”- problemi qëndronte se të gjitha këto aktivitete mund të zhvlerësohen nga ata që e kanë pushtetin. Sipas Christiane Sylvester³⁰, “fushimet e paqes nuk na çojnë në prag të luftës. Ato nuk krijojnë arsenalet armësh dhe nuk na shtojnë drejt garave të armatimeve... ato nuk kanë rëndësi”. Megjithatë duhet theksuar se angazhimi i grave në politikat e paqes ka realisht rëndësi për një numër pushtetarësh. Gjatë Luftës së Ftohtë, CIA monitorojë me interes të madh grupet e grave të asocuara me fushimet e paqes. Nuk ka të dhëna që gratë janë më të prirura të kryejnë tradhëti ndaj shtetit të tyre sesa një grup tjetër social, i quajtur burra. Megjithatë, angazhimi i grave në politikat e mbrojtjes duket se ka zgjuar një interes të theksuar shtetëror.

Lidhjet konceptuale midis “burrave dhe luftës” dhe “grave dhe paqes” janë të rëndësishme, edhe nëse ndërtohen mbi themele të pabaza. Siç ka argumentuar akademiku amerikan Bell Hooks³¹, ato nënkuptojnë se gratë, thjeshtë duke u identifikuar si gra, kanë luajtur një rol të kufizuar, për të mos thënë asnjë rol, në mbështetjen e militarizmit të shtetit. Gratë kanë një version një-dimensional të ngjarjeve historike duke qenë thjesht “vrojtues” të luftës dhe objekte të saj. Pavarësisht kësaj, gratë janë angazhuar gjithnjë në çështjet e luftës. Kjo është e rëndësishme pasi nënkupton që historia e luftës dhe, historitë në përgjithësi janë treguar në mënyrë të atillë që të nënkuptojnë vetëm: “historinë e tij”. Kësisoj gratë dhe historitë ose narracionet e tyre mungojnë në një sërë tekstesh

²⁸ Sorenson, Brigitte Refslund (1999), “Recovering from Conflict”, No.2., ff.26-27.

²⁹ Human Rights Watch, 1999, Report.

³⁰ Christiane Sylvester (1996), “The Contributions of Feminist Theory to International relations”, Cambridge.

³¹ Bell Hooks (1995), “Feminism and Militarism, a comment”

shkencore të rëndësishme të studimeve të luftës. Theksoj, se akademikët kohët e fundit janë përqëndruar përherë e më shumë në shfaqen e historive femërore dhe tashmë kemi një numër studimesh që na tregojnë historitë e grave si viktimë të luftës – për shembull, kemi monografi dhe studime që tregojnë historitë e përdhunimeve masive gjatë luftës ose analizojnë efektet që lufta ka mbi gjininë.

- **Gratë si luftëtare**

Në vitin 1990 thuajse 90 përqind e viktimave ishin civilë, shumica dërrmuese e të cilave gra dhe fëmijë. Gruaja si “viktimë” siç e kemi parë dhe më herët, është një fill i rëndësishëm në historitë e luftës, para dhe pas saj. Por studimet bashkëkohore kanë zbuluar shembuj të shumtë në të cilët gratë kanë mbështetur rolin e burrave në luftë dhe kanë marrë pjesë në lufta civile dhe në luftërat e mirëfillta. Historitë e këtyre grave hodhën një dritë intriguese mbi funksionin e femrës në luftë, duke shpalosur eksperiencat femërore si ushtarë, agjente sekrete, infermiere, kirurge, rrobalarëse, kuzhinierë dhe prostituta. Ato nuk na bëjnë të mendojmë se burrat dhe gratë ndryshojnë në mënyrë absolute. Mund të ndodhë që edhe formulime të tilla të injorojnë kontributin që kanë dhënë shumë burra në lëvizjet për paqe dhe për pacifizmin në përgjithësi. Shpeshherë, burra të veçantë kanë synuar t’i shmangen betejës dhe shumë thirrje nën armë janë bojkotuar nga dezertimi dhe nga e ashtëquajtura frikë e shkaktuar nga trauma e luftës. Në këtë shekull, duke i njohur problemet e traumës së luftës, vështirë të parashikojmë sesa gjatë mund ta mbështesim idenë e luftës si ambient heroik apo natyror për një njeri, pavarësisht përkatësisë së tij gjinore. Por kjo nuk do të thotë se gjatë luftës nuk kryhen shumë akte heroike. Lufta bashkëkohore si në rastin e pararendësve të saj, është e mbushur jo vetëm me akte barbarizmi, por edhe me akte kurajoje dhe nderi të madh. Po ashtu, kjo nuk do të thotë se nuk ka ekzistuar kurrë asnjë arsye përse lufta mund të jetë opsioni më pak i keq.

Sigurisht që mund të ekzistojnë arsye që ta bëjnë një luftë të drejtë apo edhe moralisht të nevojshme. Siç pohon edhe Michael Walzer, se gjuha e luftës së drejtë është për shumicën prej nesh “një gjuhë e dytë”: dhe si të gjitha gjuhët e dyta, nuk e flasim në mënyrë perfekte dhe duhet të pranojmë pasaktësitë tona si dhe mungesën e një fjalori të plotë³².

- **Roli i gjinisë në ndryshim**

Në Perëndim është gjithmonë luksi që të pranohen problemet e njerëzimit dhe luftës. Në 1991, kur pushoi së ekzistuari Bashkimi Sovjetik, Shtetet e Bashkuara dhe Britania bazoheshin në forca vullnetare relativisht të vogla. Rusia, e bazuar për një kohë të gjatë në rekrutime të përgjithshme të mëdha nën armë, po lëviz drejt një sistemi vullnetar. Në shumë demokraci, nocioni i ushtarit si qytetar thjeshtë ka vdekur. Por mendoj, se dhe lufta si sprovë mbijetese kombëtare, thuajse ka

³² Michael Walzer (2005), “Arguing About War”, Yale University Press.

vdekur. Në jetojmë (d.m.th ata që jetojnë në Perëndim) në një botë në të cilën lufta ndodhet në distancë të largët, viktimat tona janë të minimalizuara dhe konsiderohen të diskutueshme, kurse opsioni i preferuar i shteteve demokratike në luftë është bombardimi nga ajri. Luftat në një distancë të caktuar nga angazhimi civil kanë ndryshuar mënyrën e luftimit të ushtrive moderne dhe mënyrën e reagimit të popullsisë civile. Sikurse kemi parë gjatë konfliktit në Kosovë në fund të viteve 1990-të. Shtetet liberale ishin në gjendje të ndërmerrnin një luftë të suksesshme kundër Serbisë pa shënuar qoftë dhe një viktimitë të vetme. Natyra e këtij konflikti na bën të argumentojmë se gjinia bën shumë pak dallim në kryerjen e luftës, ndërsa ushtarët e secilës gjini nuk kishin më nevojë të vendoseshin në pozicione të rrezikshme. Teknologjia ka zgjidhur problemin e burrave, të grave dhe të luftës. Sepse duke u shmangur betejat reale, ushtarët meshkuj dhe femra mund të zhvillojnë luftë me terma të barabartë. Pas Luftës së Ftohtë ka ndryshuar natyra e luftës, nga një luftë e zhvilluar nga ushtri masive, në mbrojtje dhe përmbajtje nga armët bërthamore, për të arritur në ditët e sotme në “luftat virtuale”. Po ashtu ka ndryshuar dhe roli i burrave dhe i grave në raport me konfliktin. Mund të realizohen vrasje masive nëpërmjet teknologjisë, me shumë pak kosto reale për veten tonë. Kështu, që mendoj se është e pavend të debatohet rreth përshtatshmërisë trupore të burrave dhe grave për luftë. Po këtu shohim një problem që ngrihet rreth sigurisë së grave, luftës, zhvillimit dhe sigurisë. Ky problem konsiston në faktin se, ndërsa gjinia dhe lufta në Perëndim mund të ketë qenë për “të drejtën për të luftuar” ose të drejtën për të kundërshtuar politika shtetërore të sajara në emër të politikave kombëtare, në shumicën e mbetur të botës burrat dhe gratë kanë shumë më pak zgjedhje. Në shumë pjesë të globit, fushatat që gratë të lejohen të luftojnë dhe të vdesin në ushtritë kombëtare do të dukeshin të çuditshme. Ndërsa lufta mund të jetë e pranueshme për disa prej nesh që jetojmë në Perëndim, gratë (madje dhe burrat dhe fëmijët) në zona luftë si Afganistani, Siri Lanka, Iraku apo Amerika Latine janë viktima të luftës dhe dhunës, duke u përpjekur të largohen prej tyre gjatë gjithë kohës. Në këto raste rrallëhere konflikti ka të bëjë me një betejë për mbijetesën individuale, familjare ose komunitare në një zonë lokale. Nëse kësaj i shtohen kompleksitetet e atyre që njihen si çështje të sigurisë së butë, si SIDA, trafiku i jashtëligjshëm i njerëzve, vështirësitë ekonomike, atëherë konceptimi ynë për gjininë si një mur ndarës midis burrave dhe grave duhet përpunuar edhe më shumë për të garantuar një tablo më komplekse të asaj çka do të thotë për një burrë apo grua në një moment kohor dhe vend specifik.

Përfundime

- Analistët feministë dhe ata të gjinisë nuk bashkohen përse u takon pikëpamjeve të tyre mbi marrëdhënien midis grave, burrave dhe sigurisë.
- Feministët liberalë dëshirojnë të shohin një barazi totale të shanseve midis burrave dhe grave. Feministët liberalë dëshirojnë të marrë fund përjashtimi i grave nga jeta publike. Ata duan të shohin përfaqësimin e barabartë të grave në postet e larta të shtetit, si dhe përkrahin të drejtën e tyre për të marrë pjesë në luftë.
- Feministët radikalë do të preferonin të shihnin një ndryshim të dinamikave të aparatit të sigurisë shtetërore. Kjo përfshin mohimin e vlerave mashkullore dhe dëshirën për të

feminizuar institucionet dhe konfliktin. Disa feministë radikalë vënë theksin tek paqja si pika përfundimtare e ndryshimit të institucioneve dhe mentaliteteve.

- Feministët marksistë hulumtojnë çështjen e klasës dhe të gjinisë. Studimet e tyre nxjerrin në pah jo vetëm nënshtrimin e grave në vendet e punës, por mbi përfaqësimin e përgjithshëm të grave në grupet më të ulta socio-ekonomike anembanë globit. Ata na tërheqin vëmendjen drejt lidhjeve midis privimit ekonomik, sigurisë dhe vulnerabilitetit.
- Analiza e gjinisë është një fenomen relativisht i ri në Studimet e Sigurisë Ndërkombëtare.
- Teoricienët e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, sidomos studiuesit e sigurisë, rrallëherë kanë pranuar se gjinia është një komponent i rëndësishëm i konceptimit të shtetit, sistemit ndërkombëtar ose sigurisë ndërkombëtare.
- Analistët feministë ekspozuan dhe iu pergjigjën pyetjes se cili është roli i grave në siguri. Gjithashtu ata na ndërgjegjësojnë mbi idenë se eksperiencat e grave në lidhje me shtetin, ushtritë shtetërore dhe konfliktin janë shpeshherë shumë të ndryshme nga ato të burrave.
- Studimi i grave dhe i vendit të tyre në konfliktet bashkëkohore dhe historike ndihmoi të njëjtit e pranohej se ekzistojnë çështje specifike femërore në lidhje me kontrollin biologjik dhe riprodhimin.
- Gratë lidhen ndryshe nga burrat me politikën shtetërore.
- Gratë ndikohen në intimitetin e tyre nga politika shtetërore mbi kontraceptivët, abortin dhe martesën.
- Shtetet i përdorin shumë shpesh gratë për të përmbushur politikat e tyre shtetërore në lidhje me kërkesat demografike.
- Biologjia është jetikë për sigurinë e shtetit.
- Literatura tradicionale mbi sigurinë i ka trajtuar gratë si përkrahëse të paqes.
- Gratë janë përfshirë realisht në shumë lëvizje të fuqishme kombëtare dhe ndërkombëtare që promovojnë paqen dhe çarmatimin.
- Duhet të kuptojmë natyrën e burrave, të grave dhe lidhjen e tyre me luftën dhe paqen në kontekste specifike.
- Akti i betejës dhe sakrificës në betejë janë parë gjithnjë si një çështje jetike për shtetin.
- Qytetaria lidhet në total me dëshirën për të luftuar për atdheun.
- Studimet e kohëve të fundit tregojnë se lufta mund të mos jetë heroike dhe se gjinia nuk përbën, e vetme, një faktor përcaktues të trimërisë.
- Në disa aspekte, teknologjia i ka dhënë “neutralitet gjinor” fushës së betejës.
- Lufta merr shumë forma dhe për banorët e botës së tretë, që përfaqëson ende një betejë për mbijetesë.

Referencat

- Enloe, Cynthia (1989), *“Bahamas, Bases and Beaches”*: Making Feminist Sense of International Politics, Londër: Pinter.
- Enloe, Cynthia (2000), *“Maneuvers”*, Berkeley CA: University of California Press.
- Steans, Jill (1998), *“Gender and International Relations”*, Kembrixh: Polity Press.

- Tickner, Ann (1992), *“Gender in International Relations”*, Nju Jork: Columbia University Press.
- Van Crevald, Martin (2001), *“Men, Women and War”*, Londër: Cassell dhe Co.
- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (Janar 2005), Përmbledhje artikujsh: *“çëshjet Gjinore në Fokusin e Medias së Shkruar”*, Tiranë.
- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (Maj 2005), Përmbledhje artikujsh: *“Barazia Gjinore dhe Vendimmarrja”*, Tiranë.
- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (Janar 2005), Një udhëzues për strukturat qeveritare dhe palë të tjera të interesuara: *“Integrimi Gjinator në Sektorët e Komunikimit dhe Informimit”*, Tiranë.
- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (Maj 2005), Koncepte dhe Njohuri Bazë: *“Përkatësia Gjinore dhe Zhvillimi”*, Tiranë.
- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (Dhjetor 2005), Përmbledhje artikujsh: *“Barazia Gjinore Kusht për integrimin European”*, Tiranë.
- Doty, R.L. (1999), *“Immigration and the Politics of Security”*, Security Studies, 8, 2/3: ff. 71- 93.
- Hansen, L. (2000), *“The Little Mermaid’s Silent Security Dilemma and the Absence of Gender in the Copenhagen School”*, Millennium: Journal of International Studies, Vol. 29, No. 2: ff. 285-306.
- Alonso Harriet Hyman (1993), *“Peace as a Woman’s Issue: History of the US Movement for World Peace and Women’s Rights”*, Syracuse University Press.
- “Marrëdhëniet ndërmjet gjinive” Raport përfundimtar i aktiviteteve të grupit special për marrëdhëniet ndërmjet gjinive (EG S MS), Strasburg, Maj 1998.
- Peter Albrecht dhe Karen Barnes (2008), *“Sjellja e Politikave për Sigurinë Kombëtare dhe Gjinia”*. (Mjet praktik) Botuar me ndihmën e OSBE-së, Qendra Gjermane për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DACF) dhe Instituti Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Trajnim për Avancimin e Femrave.
- GTZ- Siguria e Popullatës dhe Gjinisë; Manual i Trajnimit rajonal (GECD DAC-OECDDAC), Doracak për Reformat në Sistemin e Sigurimit: Mbështetja e Sigurisë dhe Drejtësisë 2007
- Elstain, Jane Bethke (1987), *“Women and War”*, New York: basic Books.

Burime interneti

- www.uswsc.org
- www.womenwarpeace.org
- www.womenwagingpeace.net
- www.dcaf.ch/women

TRAJTIMI I FIGURËS SË SEVASTI QIRIAZIT NË KONTEKSTIN E EMANCIPIIMIT TË GRUAS SHQIPTARE

Bertina Salliu, studente MSH

Përmbledhje

Emancipimi i gruas është një element i rëndësishëm në një shoqëri tipike demokratike. Një ndër kushtet thelbësore për të pasur një shtet të së drejtës dhe demokratik është barazia midis njerëzve ku në një këndvështrim të përgjithshëm teorik nuk përmban asnjë kategorizim gjinor. Krahës burrit si një “shtyllë” mbështetëse në shoqëri, figura e gruas është substrakti jetik.

Në shoqërinë shqiptare fenomeni i emancipimit të gruas përbën një rëndësi me fokus të veçantë studimi për shkak të tablosë historike të larmishme dhe dinamike që kjo shoqëri ka përjetuar. Pra rrugëtimi i emancipimit të gruas është një fenomen relativisht i hershëm. Për këtë arsye dëshiroam të pasqyrojmë në këtë konferencë fillesat e hershme të këtij emancipimi duke pasur si një model ndihmës dhe qendror figurën e Sevasti Qiriazit. Kjo për shkak të veprës së rëndësishme të mirënjohur në historiografinë shqiptare. Trajtimi ynë synon të sqarojë, pohojë dhe theksojë elementët historiko-juridikë që shfaqen haptazi nëse analizojmë veprën e kësaj gruaje.

Punimi përmban në qendër të tij zhvillimin e tematikës së përzgjedhur shoqëruar me një konkluzion rreth problematikës së shqyrtuar. Për hartimin e punimit jemi mbështetur në një literaturë në gjuhën shqipe dhe anglisht kryesisht me përmbajtje historike dhe juridike.

Fjalët kyçe: emancipimi i gruas, e drejtë, barazi gjinore, shoqëria shqiptare, institucion social.

Rruga e krijimit të shtetit është shndërrimi i familjes në fshat dhe i këtij të fundit në një bashkësi më të gjerë rreth një qyteti.

- Aristoteli

Periudha në të cilën kemi marrë në shqyrtim elementin e emancipimit të gruas shqiptare përkon me dekadat e fundit të sundimit osman në hapësirën shqiptare. Në këtë kohë nuk kishte një shtet shqiptar, por këto territore ishin të inkuadruara në Perandorinë Osmane. Përfshirja për një kohë të gjatë në këtë Perandori kishte bërë të mundur përqafimin e zakoneve, sjelljeve dhe traditave

orientale. Pikërisht, edhe qëndrimi që mbahej ndaj gruas dhe trajtimi i saj kishte karakteristika që e diktonin dhe theksonin qëndrimin e gjatë nën sundimin osman. Pra është shumë herët të flasim për koncepte të tilla si “shtet demokratik,” “barazi gjinore” për shkak të patriarkalizmit që vërehej rëndom në shoqërinë shqiptare të asaj kohe. Me barazi gjinore kuptojmë gjendjen e barabartë të burrave dhe grave në shoqëri, të cilët kanë të drejta të njëjta politike e qytetare dhe marrëdhënie të barabarta me pronën shoqërore. Ndërsa me emancipim të gruas kuptojmë çlirimin e saj nga varësia, fitim të të drejtave që i përkasin dhe lënien mënjatë të paragjyqimeve ndrydhëse që e pengojnë të zhvillohet dhe të veprojë në barazi me burrin. Në bazë të Kushtetutës të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe nuk kemi këtu një ndarje të barazisë në bazë të gjinisë, por një gjithëpërfshirje.³³

Nga ana legjislativë mund të them se e drejta zakonore³⁴ shqiptare tashmë kishte pësuar një farë ndryshimi dhe ndikimi nga ky sundim dhe efekti i kulturës orientale. Kështu vërehej ekzistenca e familjeve patriarkaliste gjë që ekzistoi si mbizotëruese deri në Luftën e Dytë Botërore tek shqiptarët.³⁵ Në këto kushte duke qenë se pati një rizgjim në ndërgjegjen kombëtare shqiptare u vërejt edhe një lëvizje që ndihmoi në nxjerrjen në pah të figurës së gruas dhe fillimin e thyerjes së tabusë së kohës. Kështu, kishte pjesmarrje të grave në aktivitete bashkë me burrat dhe shumë prej tyre edhe në pozicione drejtimi dhe organizimi. Rast tipik në historiografinë shqiptare është figura e Sevasti Qiriazit. Mëposhtë po paraqesim një tablo të shkurtër të jetës së saj për ta patur të qartë veprimtarinë e saj. Sevasti Qiriaz-Dako ka lindur në vitin 1871 në Tërnovë të Manastirit dhe vdiq në vitin 1949. Ajo ishte iniciatorja e parë bashkë me të vëllanë, Gjerasimin në hapjen e shkollës së parë shqipe për Vasha dhe e vetmja delegate femër në kongresin e Elbasanit më 1909, i njohur si kongresi i Shkollave Shqipe. Familja e saj ishte shpërngulur nga fshati Peras i Kolonjës dhe ishte vendosur në fshatin Tërnovë të Manastirit ose Bitolës. Kjo kishte ndodhur në kohën e katragjyshit të Sevastisë që siç e thekson në kujtime quhej Mihal Kyrios nga kishte marrë edhe mbiemrin Qiriaz. ³⁶ Ajo mbaroi shkollën plotore në vitin 1888 në Manastir dhe më vonë shkoi në Stamboll ku studioi në kolegjin Protestant Amerikan për Vajza. Ky kolegji vazhdonte për 4 vjet, por Sevastia e përfundoi për 3 vite që të kthehej në vitin 1891 dhe të ndihmonte Gjerasimin në Korçë.³⁷ Pasi mbaroi studimet, në shkollën e Vashave përdori si tekst shkollor Dhiatën e Re.³⁸ Teksti u përdor edhe në Institutin Qiriaz. Kjo shkollë, Instituti Qiriaz, u njoh si “Pishtari flakërues i Shqipërisë.”³⁹ Në vitin 1910 u martua me Kristo Dakon dhe në vitin 1912, në Manastir botoi një “Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare” dhe në vitin 1917 botoi “Mjeshtëria për të shkruarë letra.”⁴⁰

Në periudhën në të cilën jetoi Sevastia (1870-1949) në hapësirën shqiptare kishte pasur shumë vështirësi dhe luftra që e bënë jetesën të komplikuar për popullsinë. Përveç këtij fakti, nga ana tjetër edhe roli i gruas ishte i papërfillshëm dhe për të qenë sa më objektiv duhet të themi që nuk konsiderohej shumë në shoqëri. Në këtë periudhë që Sevastia jetoi, nga ana e historiografisë zyrtare përkon pjesërisht me Rilindjen Kombëtare shqiptare. Në këtë kohë ajo ndërmori lëvizje që ndikonin

³³ Kushtetuta dhe Legjislati për reformën në drejtësi, Alb Juris 2016.

³⁴ Aleks Luarasi, *Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri* (Tiranë: Luarasi University Press, 2007), 239.

³⁵ Luarasi, *Historia e shtetit*, 239.

³⁶ Sevasti Qiriaz-Dako, *Jeta ime*, përkth. David Hosaflook & Dana Stucky (Tiranë: Vernon publishing, 2016), 45.

³⁷ Hysni Myzyri, *Shkollat e para kombëtare shqipe* (Tiranë: 8 Nëntori, 1978), 104-105.

³⁸ James Clarke, *Lëvizja kombëtare dhe Ungjilli*, përkth. Agesil Qiriaz (Tiranë: Vernon Publishing, 2017), 31.

³⁹ David Young & Edëin Jacques, *Battle of Albania* (1908-1990) (USA: AEM, 2010), 137.

⁴⁰ Clarke, *Lëvizja kombëtare*, 32.

në edukimin e gruas me qëllim emancipimin e saj dhe ndikimin në shoqërinë shqiptare në tërësi.⁴¹

Gjatë leximit në kujtimet e Sevastisë të përkthyer tashmë në dy gjuhë (shqip & anglisht) kuptohet qartë se qëllimi i jetës së saj dhe arsyeja e veprimeve që ndërmori ka qenë “*të ndriçojë, të lartësojë dhe të çlirojë njerëzit nga zgjedha e injorancës dhe besëtytnisë.*”⁴² Instituti Qiriazi, institucioni i parë femëror mbolli idetë e përparimit dhe të prosperitetit në mesin e grave shqiptare. Ky institut u hap në Tiranë dhe më tej ndërtesa u transferua në Kamëz. Për herë të parë u hap në vitin 1922 ku në tetor të këtij viti u regjistruan shumë vajza nga qytete të ndryshme të vendit dhe që kishin përkatësi të ndryshme fetare. Pra mund të përmendim këtu shumë vajza dhe gra myslimane, bektashiane dhe ortodokse.⁴³ Duhet theksuar fakti se ndër qëllimet e tjera për përparimin e kombit nëpërmjet përhapjes së gjuhës shqipe dhe shmangies së analfabetizmit, ky institut i jep rëndësi të veçantë emancipimit të gruas. Këtë fakt Sevasti Qiriazi e përmend gjerësisht në kujtimet e saj të kohës.⁴⁴

Në departamentet e institutit vërehej një frymë aktive e sistemit amerikan të mësimi. Shumë shpejt ky institut u bë një djep i arsimit dhe qytetërimit. Në kohën e Luftës së Madhe ishin shfaqur probleme të përhapjes së ndikimit të grave në veprimtarinë e armatosur me armët e nevojshme. Për të përmbushur këtë nevojë nga ky institut u vendos që të zgjidheshin një grup vajzash nga i gjithë vendi që do të bëheshin një faktor i rëndësishëm për kombin. Gjithashtu, një hap i rëndësishëm ishte edhe mësimdhënia që u vendos për gratë e martuara. Në këtë mënyrë, në institut vërehej ekzistenca e departamentit të shkencave shtëpiake ku përfshiheshin degët si: industria shtëpiake, ekonomia shtëpiake dhe pedagogjia. Kishte një departament të veçantë që merrej me mësimin e artit, muzikës dhe organizimin e koncerteve dhe shfaqjeve teatrale.⁴⁵

Me të gjitha masat e marra vërehej një farë progresi dhe një lloj pavarësie që gratë po fitonin. Kjo ishte një “*heqje e velit, një hap drejt emancipimit të gruas.*”⁴⁶ Gratë e diplomuara nga Shkolla Qiriazi kishin një përparim të shpejtë. Në vitin 1920, pas Kongresit të Lushnjës, ishte rritur nevoja për mësues. Kështu, një pjesë e tyre iu përkushtua mësimdhënies dhe pjesa tjetër organizoi shkollat në rajone të tjera të Shqipërisë dhe me njohuritë e marra gratë ishin të afta që të kryenin organizimin e nevojshëm.⁴⁷ “*Unë dhe Gjerasimi luftuam shumë për të thyer traditën e mbylljes sime kur të arrija moshën e martesës. Edhe nëna dhe babai ishin kundër shkuarjes sime në universitet.*”⁴⁸

Pavarësisht pengesave që Sevastia hasi ajo arrin që të shkojë në kolegji dhe këtë veprim e konsideroi si një bekim të madh. Në kujtimet e saj ajo përshkruan hollësisht ditën kur mori përgjigjen nga i vëllai se e kishte regjistruar në kolegjin e Vashave në Kostandinopojë. Ky akt ka një rëndësi të madhe në studimin e kësaj figure dhe për më tepër për kontekstin e kohës dhe gjendjen e gruas shqiptare. Ajo dallohet në kujtimet e saj edhe për frymën e patriotizmit dhe atdhetarizmit. Kështu, mund të themi se arsyeja tjetër që e ndikoi Sevastinë në ndërmarrjen e

⁴¹ Enriketa Papa-Pandelejmoni and Gentiana Kera, *Clio on the Margins: Women's History and Gender sensitive Scholarship in Albania*, (forum), 133.

⁴² Qiriazi-Dako, *Jeta ime*, 16.

⁴³ Myzyri, *Shkollat Kombëtare*, 106.

⁴⁴ Clarke, *Lëvizja kombëtare*, 34.

⁴⁵ Myzyri, *Shkollat Kombëtare*, 107.

⁴⁶ Qiriazi-Dako, *Jeta ime*, 268.

⁴⁷ Clarke, *Lëvizja kombëtare*, 33.

⁴⁸ Qiriazi-Dako, *Jeta ime*, 280.

nismës ishte fakti i të qenit shqiptare. Me këtë dua të nënkuptoj faktin që të qenit e ndërgjegjshme për origjinën dhe kombësinë i krijoi asaj ndjesinë e gjallë të asaj çfarë duhet të bënte. Kështu, ky fakt përcaktoi sfondin gjeografik dhe historik duke i dhënë interesimin kryesor si dhe idealin e jetës shumë herët: të ngrinte popullin e saj drejt shkollimit dhe pavarësisë.⁴⁹

Sevasti Qiriazhi ishte shqiptarja e parë që mbaronte kolegjin. Pengesat dhe vështirësitë që ajo kaloi ndikuan në veprimtarinë dhe qëllimet e saj pas mbarimit të kolegjit.⁵⁰ Duke qenë se familja Qiriazhi kishte pasur lidhje të hershme me Shoqëritë Biblike Britanike dhe Amerikane, besimi fetar për ta ishte feja protestante. Kështu, nisur nga konteksti i kohës, kushtet dhe parimet që Sevastia zbatonte, atëherë argumentohet natyrshëm që një faktorë me peshë që e shtyu atë të punonte për emancipimin ishte besimi. Këtë parim besimi ajo dëshironte që ta ndante me të gjitha gratë dhe vajzat shqiptare, që ato të ndiheshin të lira dhe të bëheshin “të zonja” për jetën e tyre. Sevastia besonte se Perëndia për gruan shqiptare kishte një dashuri të veçantë dhe se ajo do të ishte një ndër reformatoret e periudhës.⁵¹

Roli i gruas shqiptare ka ndryshuar shumë ndër vite dhe kjo ka ardhur si ndikim i faktorëve historike. Shpallja e pavarësisë e gjeti shoqërinë shqiptare në një kaos të vërtetë dhe si rrjedhim edhe gruan. Si shkak kryesor shërbeu gjendja e rënduar ekonomike, shoqërore, kulturore si edhe mentaliteti i trashëguar nga sundimi shumëvjeçar otoman. Ajo nuk kishte të drejtën e zgjedhjes së bashkëshortit të saj apo as të vendbanimit.⁵² Gruaja shqiptare shihej si një objekt që shfrytëzohej për të bërë punët e shtëpisë dhe punë të tjera të rënda. Gjithashtu niveli i ulët arsimor dhe analfabetizmi ndikoi në rolin e gruas në shoqëri. Ajo kishte qenë e shtypur ndër vite, pra kjo gjendje e mjeruar kishte qenë e trashëguar brez pas brezi.⁵³ Në shoqërinë otomane sundonin marrëdhëniet e egra feudale e patriarkale, ideologjia fetare bashkë me zakone e kanune mesjetare të vendit apo të importuara me pushtimin osman. Të gjitha këto e kishin sjellë gruan në një robëri të vërtetë. Në këtë mënyrë, ajo konsiderohej si një qenie e ulët në krahasim me burrin në çdo pikëpamje: fizike, morale, mendore.

Në këto kushte mund të themi që gruaja njohu tortura të tmerrshme dhe që nga mosha e re deri në pleqëri s’i hiqej ferexheja e çarçafi me perçen e zezë, nisur nga ligji fetar islam që zbatohet. Kjo ishte një tablo që kishin të qartë para tyre rilindasit mes të cilëve, Sevasti Qiriazhi, e cila ishte një pioniere e tyre.⁵⁴ Të drejtat e gruas ishin mjaft të kufizuara. Ajo nuk kishte të drejtë të ndërronte burrin e saj për asnjë arsye, apo të braktiste familjen. Gjithashtu ajo nuk ishte aktive në politikë. Për këto shkolla për vasha që u hapën ajo hasi në shumë vështirësi dhe sfida më e madhe e saj ishte pas vdekjes së Gjerasimit që kishte hedhur themelet e shkollës së parë shqipe dhe të shkollave për djem. Në vitet e para numri i vajzave që erdhën u rrit së tepërmi. Autoritetet osmane iu kundërvunë asaj dhe kështu e rrethuar nga shumë shoqe dhe shokë, Sevastisë iu desh që të përballonte stuhira, dallgë dhe presionet qeveritare të kohës.⁵⁵ Kjo gjendje vazhdoi deri në fillimet e vitit 1920. Më pas gjendja nisi të përmirësohej si pasojë jo vetëm e shtetit, por edhe e gruas në përgjithësi,

⁴⁹ Qiriazhi-Dako, *Jeta ime*, 28.

⁵⁰ Instituti i Historisë dhe pedagogjisë, *Historia e arsimit dhe pedagogjisë shqiptare* (Tiranë), 120.

⁵¹ Qiriazhi-Dako, *Jeta ime*, 128.

⁵² Pandejmonj & Kera, *Women's History & Gender sensitive Scholarship in Albania*, 134.

⁵³ Sinan Beqiri, *Arsimi i gruas shqiptare gjatë Rilindjes kombëtare*, St. Historike nr.1 (Tiranë: Instituti i Historisë, 1970), 103-105.

⁵⁴ Francisca de Haan, Krassimira Daskalova & Anna Loutfi, *A biographical dictionary of women's movements and feminisms (XIX-XX century)* (Budapest: CEU Press, 2006), 475.

⁵⁵ Beqiri, *Arsimi i gruas*, 113.

sidomos për hartimin dhe zbatimin e ligjeve për të drejtat e grave, arsimimi dhe roli i tyre në arenën politike të vendit.

Gratë fituan të drejtën e organizimit dhe hapjes së shkollave si: Instituti privat “Qiriazi” në Tiranë që u lartpërmend, Shkolla Femërore Normale në Korçë dhe ajo e Stigmatinëve në Shkodër. Më pas në 1933 themelohet Instituti Femëror “Nëna Mbretëreshë,” i cili përgatiste mësues. Të drejtat e gruas u rritën edhe me ndërhyrjen e saj në politikë dhe me hapjen e shoqatave apo lëvizjet femërore si “Ylli i Mëngjesit,”⁵⁶ një organizatë ku u parashtrua problemi i arsimit dhe ngritjes së rolit të femrës në shoqëri, e cilësuar si organizata e parë e gruas shqiptare, “Shpresa Kombëtare,” dhe komitetin “Gruaja Shqiptare.”⁵⁷ Tashmë gratë shiheshin si e ardhmja e arsimit në vend. Ato luajtën rol të rëndësishëm edhe në shëndetësi, luftërat e vendit dhe forcat ushtarake vullnetare. Çështja e emancipimit të gruas shqiptare u përhap gjerësisht me anë të medias së shkruar. Një rast tipik përbëjnë artikujt e ndryshëm në shqip dhe anglisht në periodikun “Yll’i Mëngjesit” që u botuan edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në vëllimin e tretë të këtij periodiku Sevastia shkruan gjerësisht për gratë shqiptare, sjelljen e tyre dhe faktorët e ndryshëm që e ndikojnë atë.⁵⁸ Vërehet një lëvdim i figurë së gruas shqiptare në këto shkrime.

Çfarë roli luan emancipimi i gruas në tërësi në një shoqëri dhe specifikisht në shoqërinë shqiptare? Emancipimi i gruas luan rol në tri aspekte: paqe, drejtësi dhe qëndrueshmërinë e institucioneve. Po ti shqyrtojmë me radhë mund të themi se zhvillimi dhe veprimi i gruas në përputhje me të drejtat e saj dhe pa u diskriminuar negativisht sjell një bashkëjetesë, harmoni, tolerancë dhe paqe në një shoqëri dhe akoma më tej një përparim të saj pasi do të kemi një gërshetim dhe ndërthurje idesh mes dy gjinive. Trajtimi në mënyrë të njëjtë, emancipimi sjell barazinë gjinore, një element të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë së një vendi. Kur ka paqe, barazi gjinore dhe tolerancë ka rrjedhimisht një garantim të drejtash në mënyrë të barabartë përpara ligjit dhe përfundimisht ky është një kusht i domosdoshëm për një shtet demokratik dhe thelb për qëndrueshmëri institucionale.

Në mbyllje të temës mund të them se për shkak të veprës që Sevastia ndërmoi, emri i saj është gjerësisht i njohur për një akt që i ndikon drejtpërsëdrejti gratë shqiptare. Emancipimi i gruas shqiptare fillimisht dallohej si një detyrë e vështirë për shkak të rrethanave. Kështu e shoh të arsyeshme që të ritheksoj edhe njëherë faktin se ajo ishte e para grua që mbaroi kolegjin dhe këtë shembull e paraqiti tek të gjitha gratë e tjera shqiptare.

Në historinë e gruas shqiptare ajo hapi siparin e emancipimit të gruas dhe fitimit të rolit dhe vendit të saj. Kështu nga lëvizjet që ajo ndërmoi u bë e mundur që gratë të çliroheshin nga tutela e zakoneve dhe kanuneve osmane të trashëguara që nuk i njihnin asnjë të drejtë gruas, por e trajtonin si një skllave. Në këtë mënyrë figura e saj ndikoi që të kthehej fokusi tek gruaja dhe në kryerjen e shumë reformave në këtë fushë në dekadat që do të vinin. Kjo lëvizje e ndërmarrë prej saj ishte si një thyerje e akullit që më vonë do të shkrinte plotësisht. Gratë shqiptare falë iniciativës së Sevastisë dhe familjes së saj mundën të parashtronin për zgjidhje problemin e tyre dhe të ndryshonin kushtet e jetesës së tyre. Kjo ishte një nismë e frytshme për kohën dhe rrethanat historike në të cilat ndodhej hapësira shqiptare. Me krijimin e shtetit shqiptar pozita e gruas do të konsolidohej së tepërmi.

⁵⁷ *Historia e arsimit*, 121.

⁵⁸ Sevasti Qiriazi, *The Women Educational Association of Massachusetts hears of “the forgotten Race,” Yll’i Mëngjesit*, vëllimi 3, nr.2, 78.

Referencat

De Haan, Francisca, Daskalova, Krassimira & Loutfi, Anna. *A biographical dictionary of Women's movements and feminisms XIX-XX century*. Budapest: CEU Press, 2006;

Instituti i Historisë & pedagogjisë shqiptare. *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*. Tiranë;

Clarke, James. *Lëvizja kombëtare dhe Ungjilli*. Përkth. Agesil Qiriaz. Tiranë: Vernon Publishing, 2017;

Qiriaz-Dako, Sevasti. *Jeta ime: Jetëshkrimi i pabotuar i Mësueses së Popullit*. përg. Dana Stucky & David Hosaflook. Tiranë: Vernon Publishing, 2016;

Sinani, Beqir. *Arsimi i gruas gjatë Rilindjes kombëtare*. St. Historike nr. 1. Tiranë: Instituti i Historisë, 1970;

Young, David & Jacques, Edwin. *Battle of Albania 1908-1990*. USA: AEM, 2010;

Luarasi, Aleks. *Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri*. Tiranë: Luarasi University Press, 2007;

Kushtetuta dhe Legjislacioni për reformën në drejtësi. Alb Juris, 2016;

Qiriaz, Sevasti. *The Women Educational Association of Massachusetts hears of "the forgotten Race."* Yll'i Mëngjezit, nr.2;

Papa-Pandelejmoni, Enriketa & Kera, Gentiana. *Clio on the Margins: Women's History and Gender sensitive Scholarship in Albania*;

Myzyri, Hysni. *Shkollat e para kombëtare shqipe*. Tiranë: 8 Nëntori, 1979;

PAQJA, DREJTËSIA, INSTITUCIONET E FORTA DHE BARAZIA GJINORE, SI FAKTORË PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË

Brunilda Malkollari, studente MSH

Përmbledhje

Barazia gjinore, është një faktor kyç për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.⁵⁹ Duke hequr barrierat dhe duke nxitur pjesëmarrjen e grave në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre, mund të arrihet suksesi në zhdukjen e varfërisë dhe pabarazisë, ndryshimet klimatike dhe konfliktet dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi ekonomik i grave nuk është i rëndësishëm vetëm nga perspektiva e realizimit të të drejtave të grave, por është gjithashtu një kontribut i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të një vendi.⁶⁰

Garantimi i të drejtave të grave dhe dhënia e mundësive për të arritur potencialin e tyre të plotë është thelbësor jo vetëm për arritjen e barazisë gjinore, por edhe për përmbushjen e një sërë objektivash ndërkombëtare për zhvillimin.⁶¹ Pabarazia gjinore është një nga pengesat më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm, rritjen ekonomike dhe uljen e varfërisë.⁶² Një nga elementët thelbësorë për fuqizimin e gruas është dhe arsimimi. Sipas Nelson Mandelës, edukimi është arma më e fuqishme që mund të përdorim për të ndryshuar botën.⁶³ Edukimi është i njohur globalisht si mjeti më i fuqishëm i fuqizimit të vajzave dhe grave dhe mbrojtjen e tyre nga shkelja e të drejtave të tyre.

Pjesëmarrja e grave në vendim-marrje, forcon demokracinë dhe kontribuon në zhvillimin e suksesshëm të shoqërisë.⁶⁴ Rëndësia e konceptit të barazisë gjinore dhe pjesëmarrja e gruas në qeverisjen lokale dhe qendrore ka marrë një rëndësi të veçantë në arenën ndërkombëtare.⁶⁵ Siç do shprehej dhe Anne Hidalgo, kryebashkiake e Parisit: “Ndërtimi i demokracisë nuk mund të kuptohet pa kontributin e shquar të grave dhe puna jonë duhet të përqendrohet duke paraqitur propozime konkrete që na ndihmojnë për të ndryshuar situatën në shoqëritë tona”.⁶⁶

Fjalët kyçe: barazi gjinore, të drejta të grave, demokraci, diskriminim gjinor, arsimim.

⁵⁹<https://www.undp.org/content/undp/en/home/gender-equality.html>

⁶⁰https://www.uclg.org/sites/default/files/women_paris_2015- eng-web_0.pdf

⁶¹<https://www.peacecorps.gov/educators/resources/global-issues-gender-equality-and-womens-empowerment/>

⁶²<https://www.eda.admin.ch/deza/en/home/themes-sdc/gender-equality.html>

⁶³<https://www.w4.org/en/education/>

⁶⁴https://www.uclg.org/sites/default/files/the_role_of_local_governments_in_promoting_gender_equality_for_sustainability.pdf

⁶⁵https://www.uclg.org/sites/default/files/women_paris_2015- eng-web_0.pdf

⁶⁶https://www.uclg.org/sites/default/files/the_role_of_local_governments_in_promoting_gender_equality_for_sustainability.pdf

Të drejtat e njeriut janë universale dhe gëzohen nga të gjithë në mënyrë të barabartë. Megjithatë në shoqëri ekzistojnë sjellje që trajtojnë në mënyrë të diferencuar për shkaqe të ndryshme ku mund të përmendim për shkak të racës, statusit shoqëror, fesë apo përkatësisë gjinore. Parimi sipas të cilit të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejta të barabarta dhe duhet të trajtohen njësoj, paraqet bazën e kuptimit të të drejtave të njeriut dhe rrjedh nga dinjiteti i barabartë njerëzor i çdo individi⁶⁷. Sot, demokratizimi i sistemit ka ndikuar pozitivisht edhe në demokratizimin e familjes e shoqërisë⁶⁸. Arsimimi gjithashtu është një faktor kyç që ngushton hendekun midis burrave dhe grave në përdorimin e mundësive social-ekonomike.

Barazia gjinore është parim i filozofisë sociale që nënkupton barazinë e burrave, grave dhe personave me identitete të ndryshme gjinore në jetën shoqërore dhe politike. Barazia gjinore është gjithashtu një parakusht për avancimin e zhvillimit dhe reduktimin e varfërisë⁶⁹. Gratë e fuqizuara kontribuojnë në shëndetin dhe produktivitetin e familjeve dhe komuniteteve të tëra dhe përmirësojnë perspektivat për gjeneratën e ardhshme.⁷⁰ Fuqizimi i grave redukon varfërinë, nxit zhvillimin dhe adreson sfidat më urgjente në botë⁷¹.

Qëllimi parësor i çdo shoqërie është arritja e mirëqenies shoqërore në shkallën më të lartë. Fuqizimi i grave, gjithashtu ka aftësinë për të krijuar efekte të panumërta të tjera: për të krijuar një botë më të shëndetshme, me më shumë të arsimuar, dhe me më pak të varfër.⁷²

Të gjitha gratë duhet të kenë mundësinë t'i drejtohen institucioneve të drejta dhe efektive për të pasur qasje në drejtësi dhe shërbime thelbësore.⁷³ Pa institucione të forta dhe efektive **padrejtësia do të përhapej, dhe diskriminimi do të vazhdonte akoma më tej**. Si në vendet e zhvilluara e gjithashtu në vendet në zhvillim **një sërë institucionesh vazhdojnë të mos jenë efektive** e madje kanë dështuar të mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna apo diskriminimi me bazë gjinore.⁷⁴

Kjo pasqyron gjendjen e mjerueshme të grave dhe vajzave, të cilat shpeshherë duke qenë se nuk kanë gëzuar mbrojtje ligjore nga institucionet, kryejnë vetëvrasje apo mund të vriten nga partnerët e tyre ose familjarët. Për fat të keq duke qenë se nuk kanë funksionuar institucionet në Shqipëri kemi shifra alarmante të vrasjeve ndaj grave. Kështu të dhënat tregojnë se viktimat e dhunës në Shqipëri përballen me mungesën e shërbimeve sociale dhe indiferencën e institucioneve publike⁷⁵. Shërbimet për familjen nga bashkitë dhe komuniteti, pothuaj nuk ofrohen fare pavarësisht se bashkitë e kanë për detyrë t'i ofrojnë këto shërbime.⁷⁶ Në vendin tonë këto 8 vitet e fundit kanë humbur jetën 106 gra dhe vajza, viktimat e dhunës në familje, 73 prej të cilave janë vrarë nga bashkëshortët e tyre.⁷⁷ Në Shqipëri dhuna në familje vazhdon të jetë e përhapur në të gjitha shtresat

⁶⁷<https://sites.google.com/site/avokatiorg/in-the-news/personsnamesnewwebsitewinswobbyaward>

⁶⁸<https://2lonline.com/roli-gruas-ne-familje-e-shoqeri-dhe-angazhimi-saj-ne-politike/>

⁶⁹<https://albania.unfpa.org/sq/topics/t%C3%AB-drejtat-e-njeriut-dhe-barazia-gjinore>

⁷⁰<https://albania.unfpa.org/sq/topics/t%C3%AB-drejtat-e-njeriut-dhe-barazia-gjinore>

⁷¹<https://albania.unfpa.org/sq/topics/t%C3%AB-drejtat-e-njeriut-dhe-barazia-gjinore>

⁷²<https://irisdamani.wordpress.com/2013/01/21/fuqizimi-i-gruas-eshte-i-rendesishem-per-shoqerine>

⁷³<http://www.unwomen.org/en/news/in-focus/women-and-the-sdgs/sdg-16-peace-justice-strong-institutions>

⁷⁴<http://www.unwomen.org/en/news/in-focus/women-and-the-sdgs/sdg-16-peace-justice-strong-institutions>

⁷⁵<https://www.kohajone.com/2018/11/29/shifrat-e-frikshme-lista-me-grate-dhe-vajzat-e-vrara-nga-dhuna-ne-familje-gjate-2018-es/>

⁷⁶<https://www.kohajone.com/2018/11/29/shifrat-e-frikshme-lista-me-grate-dhe-vajzat-e-vrara-nga-dhuna-ne-familje-gjate-2018-es/>

⁷⁷<http://www.gsh.al/2018/11/27/statistikat-e-frikshme-mbi-106-gra-te-vrara-gjate-8-viteve-te-fundit/>

e shoqërisë. Sipas INSTAT/UNDP, mbi 53% e tyre, ose rreth 750 mijë gra dhe vajza në Shqipëri deklarojnë se kanë qenë të paktën një herë në jetën e tyre viktime të dhunës në familje.⁷⁸

E dhëna është publikuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimet dhe Drogën (UNODC), në një raport të fundit të saj **“Studimi global për vrasjet e lidhura me gjininë për gratë dhe vajzat”** ku Shqipëria kishte nivelin më të lartë të vrasjeve nga partnerët intimë, me 0.7 vrasje për 100 mijë gra, sipas të dhënave që i referohen vitit 2016⁷⁹. Ky është niveli më i lartë në Europë.

Sigurisht janë bërë përpjekje si në arenën ndërkombëtare, ashtu dhe brenda shteteve janë hartuar strategji për forcimin e institucioneve, arritjen e paqes dhe drejtësisë.⁸⁰ **Agjenda e vitit 2030** kërkon **një përfshirje më të madhe midis qeverive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare** për të ndërtuar **shoqëri të drejtamë paqësore dhe përfshirëse**.⁸¹ Paqja gjithashtu sjell mundësi të reja biznesi **duke rritur stabilitetin**, duke përmirësuar **perspektivat ekonomike**. Agjenda e vitit 2030 gjithashtu trajton çështjet që janë pasqyruar në Deklaratën e Mijëvjeçarit duke përfshirë çështje të tilla si **institucione efektive, qeverisje të mirë, sundim të ligjit dhe shoqëri paqësore**.⁸²

Një aspekti i ri i Agjendës së 2030 është **universaliteti** - që do të thotë se zbatohet për të **gjitha vendet** në të gjitha nivelet e zhvillimit, duke marrë parasysh kapacitetet dhe rrethanat e tyre të ndryshme.⁸³ Zbatimi do të nxitet nga një **Partneritet i ri Global** i karakterizuar nga përgjegjësia e përbashkët, llogaridhënia reciproke dhe angazhimi nga të gjithë.⁸⁴

Një nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara është gjithashtu dhe **Objektivi nr. 16** Ajo **"promovon shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe ndërtton institucione efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet"**.⁸⁵ Kjo synon të promovojë shoqëritë paqësore në nivel kombëtar, si dhe rolin e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar. Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë projekti për të arritur **një të ardhme më të mirë dhe më të qëndrueshme për të gjithë**.⁸⁷ Promovimi i **shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe përfshirëse** në të gjitha nivelet janë disa nga qëllimet më të rëndësishme të objektivit nr 16. Reduktimi i kriminalitetit, trafikimit të qenieve njerëzore, punës dhe abuzimi me fëmijët janë qëllime globale.⁸⁸

Një objektiv i rëndësishëm është dhe **objektivi nr.5**. Sipas OKB-së, "barazia gjinore nuk është vetëm një e drejtë themelore e njeriut, por një themel i domosdoshëm për një botë **paqësore, të begatë dhe të qëndrueshme**".⁸⁹ Sigurimi me qasje të barabartë në arsim, kujdes shëndetësor, punë të denjë dhe përfaqësim në proceset vendimmarrëse politike dhe ekonomike i grave dhe vajzave

⁷⁸<http://www.gsh.al/2018/11/27/statistikat-e-frikshme-mbi-106-gra-te-vrara-gjate-8-viteve-te-fundit/>

⁷⁹<http://shekulli.com.al/raporti-shqiperia-e-para-ne-europe-per-vrasjet-ne-cift/>

⁸⁰<https://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>

⁸¹<https://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>

⁸²<https://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>

⁸³https://ec.europa.eu/europeaid/policies/european-development-policy/2030-agenda-sustainable-development_en

⁸⁴https://ec.europa.eu/europeaid/policies/european-development-policy/2030-agenda-sustainable-development_en

⁸⁵<https://sdg-tracker.org/peace-justice>

⁸⁶<https://sdg-tracker.org/peace-justice>

⁸⁷<https://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>

⁸⁸<https://sdg-tracker.org/peace-justice>

⁸⁹<https://www.un.org/sustainabledevelopment/gender-equality/>

do të forcojë ekonominë në zhvillim dhe do të përfitojnë shoqëritë dhe njerëzimi në përgjithësi.⁹⁰ Arritja e barazisë gjinore do të kërkojë legjislacion që promovon **fuqizimin e të gjitha** grave dhe vajzave dhe kërkon arsim të mesëm për të gjitha vajzat.⁹¹ Objektivat kërkojnë për t'i dhënë fund diskriminimit gjinor dhe për fuqizimin e grave dhe vajzave përmes teknologjisë⁹². SDG-të mund të japin ndryshime transformuese për vajzat vetëm nëse vajzat konsultohen, ku prioritetet dhe nevojat e tyre duhet të merren parasysh.⁹³

Megjithatë, pavarësisht problematikës „Shqipëria ka njohur ndryshime të pozitës së gruas. Në Shqipëri janë bërë përpjekje për të përmisuar legjislacionin ku shteti shqiptar nga ana e tij ka miratuar ligjet e barazisë gjinore që synojnë t'u **japin grave mundësi të barabarta në çdo fushë të jetës**. Megjithatë, ajo që vihet re është se pavarësisht se janë miratuar këto ligje, **ka një mungesë në zbatimin e tyre**. Ky fakt është konstatuar nga organizatat joqeveritare ku presidentja e shoqatës “Rrjeti i grave Milenium do të shprehej se “; *“Shqipëria ka ligje të mira, problemi me Shqipërinë është se sa implementohen këto ligje. Dhe ky është problemi edhe me barazinë gjinore, i cili megjithëse u miratua në vitin 2004 asnjëherë nuk u zbatua”*⁹⁴.

Një publikim i vitit 2017 nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në Shqipëri dhe UN Women, i cili analizon barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, vlerësoi përpjekjet e deritanishme në vend, por theksoi se më shumë duhet bërë për përmirësimin e jetës së grave dhe vajzave në Shqipëri. **Dosja Gjinore**, përqendrohet në shtatë sektorë kyç ku ende vazhdojnë pabarazitë gjinore dhe diskriminimi gjinor dhe hedh dritë mbi format e veçanta të diskriminimit të shumëfishtë me të cilin përballen grupet e pafavorizuara dhe të marginalizuara të grave dhe vajzave⁹⁵. Raporti thotë se: *“Sot gratë në Shqipëri përballen me vështirësi dhe pengesa të shumta në aksesin në tregun e punës dhe vazhdojnë të mbajnë barrën e shumëfishtë të roleve tradicionale gjinore”*⁹⁶.

Ekonomia dhe pavarësia financiare janë bazat e forcimit të pozitës së gruas në shoqëri. Por kjo shpeshherë është e vështirë të arrihet, për shkak të praktikave diskriminuese të punësimit, veçanërisht në sektorin privat⁹⁷. Ky fakt evidentohet në raport ku thuhet se: *Përfshirja dhe fuqizimi ekonomik i grave mbetet problematik. Pjesëmarrja e grave në forcën e punës është e ulët dhe një përqindje e lartë e grave dekurajohen të hyjnë në tregun e punës. Përveç kësaj, puna e përkujdesit të papaguar është fushë ekskluzive e grave, çka pengon pjesëmarrjen e tyre në punë prodhuese dhe të paguar”*⁹⁸. Diferenca në paga mes grave dhe burrave mund të cilësohet si një nga faktorët që sjell ndikim në rritjen e pabarazisë mes tyre⁹⁹. Për të njëjtën punë, realiteti dëshmon se burrat janë më të paguar përkundrejt grave¹⁰⁰. Shqipëria duhet të punojë fort për të zvogëluar hendekun ekonomik midis dy gjinive dhe të huazojë nga modelet e shoqërive më të suksesshme. Një nga

⁹⁰<https://www.un.org/sustainabledevelopment/gender-equality/>

⁹¹<http://www.unwomen.org/en/news/in-focus/women-and-the-sdgs/sdg-5-gender-equality>

⁹²<https://www.theguardian.com/global-development-professionals-network/2015/jun/02/21-ways-the-sdgs-can-have-the-best-impact-on-girls>

⁹³<https://www.theguardian.com/global-development-professionals-network/2015/jun/02/21-ways-the-sdgs-can-have-the-best-impact-on-girls>

⁹⁴<https://www.zeramerikes.com/a/a-30-2008-07-06-voa4-85620747/424217.html>

⁹⁵<https://www.reporter.al/barazia-gjinore-ne-shqiperi-rruge-e-gjate-drejt-balancimit-te-peshores-burra-gra/>

⁹⁶<https://www.reporter.al/barazia-gjinore-ne-shqiperi-rruge-e-gjate-drejt-balancimit-te-peshores-burra-gra/>

⁹⁷<https://www.reporter.al/barazia-gjinore-ne-shqiperi-rruge-e-gjate-drejt-balancimit-te-peshores-burra-gra/>

⁹⁸<https://www.reporter.al/barazia-gjinore-ne-shqiperi-rruge-e-gjate-drejt-balancimit-te-peshores-burra-gra/>

⁹⁹<https://luarasi-univ.edu.al/barazia-gjinore-dhe-politikat-ekonomike/>

¹⁰⁰<https://luarasi-univ.edu.al/barazia-gjinore-dhe-politikat-ekonomike/>

modelet më të suksesshme në integrimin e gruas janë shtetet skandinave. Këto shtete ishin të pazhvilluara ekonomikisht ku madje qytetarët u larguan drejt Shteteve të Bashkuara, për një jetë më të mirë¹⁰¹. Që nga ajo kohë, ata përdorën të gjitha resurset kombëtare, madje fuqizuan rolin e gruas duke bërë të mundur të bëhen shtete të përparuara jo vetëm nga pikëpamja ekonomike por dhe ajo sociale, kulturore etj¹⁰².

Në zgjedhjet Parlamentare të vitit 2009 pjesëmarrja e grave në parlament u rrit me më shumë sesa dyfishi nga 7 % në 16 %. Tendenca në rritje vihet re edhe në zgjedhjet parlamentare 2013 ku arriti në 18 %¹⁰³. *“Pavarësisht nga arritjet e konsiderueshme, praktika e vendosjes së grave në fund të listës së kandidatëve, për shembull, ende vazhdon. Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013 partitë kryesore politike u gjobitën nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për mosrespektim të kuotave gjinore. Një tjetër dukuri që u vu re ishte tërheqja e kandidateve gra nga lista e kandidatëve për t’ua lënë vendet bosh burrave, të cilët u bënë pastaj deputetë”*¹⁰⁴.

Barazia gjinore është baza për një zhvillim të qëndrueshëm të drejtë dhe gjithëpërfshirës. Në fjalimin e tij për Ditën Ndërkombëtare të Gruas, ambasadori Soreca do të shprehej se: *Ofrimi i mundësive të barabarta grave dhe vajzave, si dhe qasje në arsim, kujdes shëndetësor, punë të denjë, përfaqësim në proceset vendimmarrëse politike dhe ekonomike do të ushqejë ekonomi të qëndrueshme dhe do të jetë në dobi të të gjithë shoqërisë.*¹⁰⁵

Barazia gjinore nuk është vetëm një çështje e të drejtave të njeriut, por gjithashtu ka efekte të forta dhe pozitive në ekonomi.¹⁰⁶ Barazia gjinore është një parakusht themelor për zhvillimin dhe rritjen e qëndrueshme. Përrjashtimi i grave nga çdo sektor i jetës do të thotë të krijosh pengesa për progresin dhe disavantazhe për shoqërinë, pasi mbeten të pashfrytëzuara e gjysma e aftësive dhe talentit të popullsisë¹⁰⁷.

Barazia gjinore është një tjetër faktor kyç që ndikon në paqen dhe zhvillimin e një shoqërie në të gjitha aspektet. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm nuk mund të arrihen pa siguruar barazinë gjinore në ligj dhe në praktikë, e nuk mund të kemi përparim të shoqërisë, paqe dhe siguri pa sundimin e ligjit.¹⁰⁸

Për shkak se dhuna në baza gjinore përbën një pengesë të madhe për drejtësinë, shtete te ndryshme, përfshirë Shqipërinë kanë marrë masa dhe janë përpjekur të ashpërsojnë dënimet për individë që ushtrojnë forma të ndryshme të dhunës, duke përfshirë dhunën seksuale, fizike, psikologjike. Ndryshimi i legjislacionit, aplikimi i sanksioneve më shtrënguese dhe drejtësia efektive do të eliminonin në mënyrë të konsiderueshme format e ndryshme të dhunës ndaj grave dhe uljen e kriminalitetit.

Pesëmarrja e grave në politikë, është një faktor mjaft pozitiv për zhvillimin harmonik të shoqërisë. Edhe pse janë bërë përparime, me vendosjen e kuotave gjinore ku 30% e kandidatëve në zgjedhje duhet të jenë femra¹⁰⁹, partitë politike shpeshherë janë gjobitur për shkak se nuk e respektojnë këtë kriter. Sipas Majlinda Bregut, çdo debat për barazinë gjinore duhet ta ketë pikënisjen nga

¹⁰¹<http://www.revistateuta.com/content/?id=87>

¹⁰²<http://www.revistateuta.com/content/?id=87>

¹⁰³<http://www.monitor.al/grate-ne-politike-ja-se-evoluoi-perfaqesimi-tyre-qe-nga-1920/>

¹⁰⁴<https://www.reporter.al/barazia-gjinore-ne-shqiperi-rruge-e-gjate-drejt-balancimit-te-peshores-burra-gra/>

¹⁰⁵https://eeas.europa.eu/delegations/australia/59308/node/59308_sq

¹⁰⁶<http://www.unece.org/gender/welcome-new/snapshot-gender-equality.html>

¹⁰⁷http://www.unece.org/fileadmin/DAM/Gender/publications_and_papers/UNECE_Policy_on_GEEW_Final.pdf

¹⁰⁸<https://news.un.org/en/story/2019/03/1035291>

¹⁰⁹ Kodi Zgjedhor i RSH

mundësitë që kanë gratë për të pasur një punë e për të pasur mundësitë financiare për të rritur fëmijët e tyre e pas kësaj mund të diskutohet promovimi i grave në poste drejtuese apo edhe në politikë.¹¹⁰

Efektiviteti i strategjive të barazisë gjinore është i kushtëzuar nga ekzistenca e kornizave institucionale, financimi adekuat, kapaciteti i vazhdueshëm në të gjithë institucionet qeveritare.¹¹¹ Ashtu si ish - Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Anan do shprehej se: *"Barazia gjinore është më shumë se një qëllim në vetvete, është parakusht për të përmbushur sfidën e reduktimit të varfërisë, nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe ndërtimin e qeverisjes së mirë"*.¹¹² Paqja, drejtësia dhe institucionet e forta janë elementët thelbësorë që ndikojnë mbi barazinë gjinore e gjithashtu për përparimin dhe zhvillimin e shoqërive dhe shteteve.

¹¹⁰<https://www.vizionplus.tv/bregu-ne-beograd-fuqizimi-i-gruas-nepermjet-punesimit/>

¹¹¹<https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/9789264280359-7-en.pdf?expires=1555923546&id=id&accname=guest&checksum=FEB9063CAD610B76FA66B231885D4C6D>

¹¹²<https://www.bi.edu/content/winter-is-coming/empowering-gender-equality/>.

**TË DREJTAT E NJERIUT NË EUROPE DHE MBROJTJA E TYRE.
MOSDISKRIMINIMI SI NJË NGA PARIMET BAZË NË RESPEKTIMIN E TË
DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE**

Dorian Leskoviku, doktorant, UT

Përmbledhje

Të drejtat e njeriut kanë qenë dhe janë një ndër çështjet më problematike dhe të cilat janë adresuar në qasje shumë-dimensionale. Gjatë shekullit të XX-të manifestohen përpjekjet e para në nivel ndërkombëtar për afirmimin dhe mbrojtjen e tyre, kryesisht nga organizata ndërkombëtare. Të drejtat e njeriut, deri në zhvillimet e shekullit të XIX-të, përdorshin vetëm në kuptimin negativ që do të thotë se këto të drejta gëzoheshin në mënyrë të pavarur nga ndërhyrja e shtetit. Megjithatë, me kalimin e kohës, u pa e domosdoshme ndërhyrja e shtetit, në mënyrë që gëzimi i të drejtave të njeriut të mos shoqërohej me pasigurinë e cila u shfaq sidomos gjatë dy luftërave botërore, ngjarje këto që vunë në lëvizje shtetet për të marrë masat e nevojshme. Kjo është periudhë në të cilën del në pah roli i organizatave ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Organizata e Kombeve të Bashkuara ishte e para organizatë që njohu rëndësinë për sanksionimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut me anë të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ)¹¹³. Deklarata, në pjesën e hyrjes konfirmon se "...popujt e Kombeve të Bashkuara vërtetuan përsëri në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e njeriut dhe barazinë midis burrave dhe grave".

Pas OKB-së, një sërë organizatash të tjera ndërkombëtare dhe rajonale vunë në qendër të axhendave të tyre të drejtat e njeriut. Mes tyre padyshim që rol me rëndësi ka luajtur dhe luan Këshilli i Europës, një organizatë rajonale e cila i përkushtohet plotësisht të drejtave të njeriut dhe që për herë të parë, parashikoi (përmes KEDNJ-së) dhe mekanizmat mbrojtëse për garantimin e respektimit të tyre.

Fjalët kyçe: të drejtat e njeriut, KEDNJ, mosdiskriminim, traktate ndërkombëtare, barazi gjinore.

- **Hyrje**

"Asgjë nuk është e mundur pa njerëzit; por asgjë nuk mund të zgjasë pa institucionet"

- Jean Monnet

¹¹³ DUDNJ u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 10 dhjetor 1948.

Të drejtat e njeriut janë të lidhura ngushtë me ekzistencën e njeriut. Ato kanë një rëndësi themelore, dhe janë të pandashme, të pazëvendësueshme dhe të patjetërsueshme¹¹⁴. Koncepti i të drejtave të njeriut është një koncept i lidhur ngushtë me konceptin e përgjithshëm të së drejtës si një ndër elementët mbi të cilët bazohet vetë krijimi dhe ekzistenca e një shteti.

Të drejtat e njeriut filluan të zhvillohen si koncept që prej momentit kur njerëzit krijuan shtetin dhe i dhanë atij disa të drejta, me kusht që ai të merrte përsipër mbrojtjen më të mirë të të drejtave të tjera që ata mbajtën. Ky është thelbi i të ashtuquajturës “Kontrata Sociale” të elaboruar nga Jean Jacques Rousseau. Me evoluimin e shoqërisë njerëzore, njerëzit u bënë më të ndërgjegjshëm për të drejtat që duhet të gëzonin që në momentin e lindjes, të cilat nuk ua dhuronte shteti por që ishte i detyruar t’i njihte dhe të krijonte instrumentet shtetërore për mbrojtjen dhe sanksionimin e tyre.

Të drejtat e njeriut janë themeli i lirisë, paqes dhe drejtësisë për vendosjen e mirëqenies së përbashkët, si mekanizëm që avancojnë statusin dhe rolin e njeriut në shoqëri. Të drejtat e njeriut duhet të shërbejnë për shprehjen e lirisë, barazisë, paqes dhe drejtësisë. OKB ka krijuar mekanizma për të promovuar dhe mbrojtur këto të drejta dhe për të ndihmuar shtetet në kryerjen e detyrimeve të tyre. Themelet e tij janë Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut¹¹⁵. Pavarësisht se DUDNJ-ja u kiratua si rezolutë dhe jo si traktat detyrues, sërish vlera e saj është e padiskutueshme, pasi ajo ka shërbyer si model për traktate të tjera ndërkombëtare që e kanë pasuar në fushën e të drejtave të njeriut¹¹⁶.

Që atëherë, OKB ka zgjeruar gradualisht konceptin e të drejtave të njeriut për të përfshirë standarte specifike edhe për grupe të caktuara sociale si: për gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, pakicat dhe grupet e tjera të prekshme, të cilët tani posedojnë të drejta që i mbrojnë ata nga diskriminimi, fenomen që ka qenë prej kohësh i pranishëm në shumë shoqëri.

• Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ)

Këshilli i Europës u krijua në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, duke ndjekur modelin e OKB-së. Ndër synimet kryesore të tij, së bashku me forcimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës, janë mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të njeriut dhe dinjitetin njerëzor dhe zhvillimi social¹¹⁷. Ky synim arrihet përmes: a) mbikqyrje efektive dhe mbrojtje e të drejtave dhe lirive themelore; b) identifikim i kërcënimeve të reja për të drejtat e njeriut; c) zhvillim i ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e të drejtave të njeriut; dhe ç) nxitje e edukimit dhe e trajnimit profesional për të drejtat e njeriut. Ndër dokumentet më kryesore që ai miratoi, padyshim që vend qendror zë KEDNJ-ja¹¹⁸.

KEDNJ shënon një hap përpara krahasuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, sepse nuk kufizohet vetëm në shpalljen e të drejtave të njeriut por parashikon një sistem të veçantë për garantimin e këtyre të drejtave duke detyruar vendet anëtare të përmbushin detyrimet që burojnë

¹¹⁴ Kushtetuta e RSH, neni 15/1.

¹¹⁵ *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ)*, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1948), www.un.org/en/universal-declaration-human-rights.

¹¹⁶ *Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut*, Manual për Administratën Publike, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Tiranë, Qershor, 2016, f.38.

¹¹⁷ *Handbook on European data protection law*, European Union Agency for Fundamental Rights & Council of Europe, 2014, Printed in Belgium, 2014, f.14.

¹¹⁸ KEDNJ u hartua në Romë më 4 Nëntor 1950 dhe hyri në fuqi më 8 Shtator 1953 për vendet anëtare të Këshillit të Europës. Shqipëria e ratifikoi këtë Konventë në vitin 1996.

nga kjo Konventë. Kjo trashëgimi europiane është e hershme, dhe i ka rrënjët në kulturën humaniste, e cila i vë të drejtat mbi pushtetin”.¹¹⁹

Kjo Konventë mund të quhet një kartë kushtetuese e të drejtave themelore civile dhe politike për vendet anëtare të Këshillit të Europës, është dokument me vlerë të përbashkët për demokracinë europiane, një rend juridik në sferën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë katalogun e të drejtave të mbrojtura, zgjeruar me Protokollet shtesë dhe interpretimet e organeve të saj, si dhe një mekanizëm për respektimin dhe mbrojtjen e tyre siç është GJEDNJ-ja. Sistemi i mbrojtjes nga GJEDNJ vendos në ekuilibër mbrojtjen kombëtare me atë ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe e bën sistemin e mbrojtjes funksional. GJEDNJ duhet parë nga individët si shkallë e fundit e ankimit. Para saj, shtetet duhet të testojnë veten për të provuar që sistemet e tyre politike mund të quhen demokratike¹²⁰.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore ka për qëllim të mbrojë dhe garantojë, në shtetet që e kanë ratifikuar atë, të drejtat dhe liritë themelore civile dhe politike. Konventa i zgjeroi të drejtat dhe liritë e garantuara nëpërmjet Protokolleve shtesë, ku aktualisht ato janë 16, por jo të ratifikuara nga të gjitha shtetet anëtare¹²¹.

Të drejtat e garantuara nga Konventa dhe Protokollet shtesë të saj u takojnë jo vetëm shteteve, por secilit që ndodhet, madje dhe për një kohë të shkurtër, në territorin e një shteti ose jashtë tij, por në kufijtë e juridiksionit të tij¹²². Pjesa më e madhe e të drejtave dhe detyrimeve mund të kufizohet. Absolute janë: ndalimi i torturës, trajtimit dhe dënimit çnjerëzor e poshtërues (neni 3), ndalimi i dëbimit masiv të të huajve (neni 4 i Protokollit Nr 4) si dhe ndalimi i gjykit apo dënimit 2 herë për të njëjtën vepër penale (neni 4 i Protokollit Nr 7).

Neni 17 i Konventës parashikon ndalimin e shpërdorimit të të drejtave. Asnjë shtet, grup personash apo person nuk mund t’i njohë vetes të drejtën për të ndërmarrë hapa apo për të kryer veprime që synojnë të shkatërrojnë të drejtat dhe liritë e parashikuara në të, apo të vendosë kufizime të tyre në një masë më të rëndë sesa ajo që parashikon Konventa. Përveç kësaj, kufizimet e të drejtave dhe lirive për aq sa lejon Konventa, nuk mund të përdoren për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë parashikuar¹²³.

Pjesa më e madhe e shteteve anëtare të Këshillit të Europës e ka njohur Konventën si pjesë e të sistemit juridik, të barabartë me legjislacionin e brendshëm. Si rezultat, dispozitat e Konventës mund të përbëjnë bazë të pavarur për shqyrtimin e kërkesave para gjykatës apo organeve të tjera¹²⁴. Por edhe në rastet kur Konventa mbetet vetëm një detyrim ndërkombëtar i shtetit, qeveria duhet të kujdeset që e drejta dhe praktika të mos jenë në kundërshtim me parimet që rrjedhin prej saj.

¹¹⁹ Arben Puto, “Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut në përjasje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, Albin, Tiranë 2002, fq 6.

¹²⁰ *Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut*, Manual për Administratën Publike, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Tiranë, Qershor, 2016, f.37.

¹²¹ *Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore* (KEDNJ) dhe Protokollet Shtesë; www.coe.int.

¹²² *Manual për Ligjin Evropian të Mbrojtjes nga Diskriminimi*, Agjensia e BE për të Drejtat Themelore të Njeriut dhe Këshilli i Evropës, Korrik 2010, f.9; marrë nga: www.echr.coe.int.

¹²³ Neni 18 i KEDNJ-së.

¹²⁴ *Handbook on European data protection law*, European Union Agency for Fundamental Rights & Council of Europe, 2014, Printed in Belgium, 2014, f.14.

- **Mbrojtja e të drejtave të gruas dhe mosdiskriminimi**

Tema e mbrojtjes së të drejtave të grave është bërë objekt studimi dhe debatesh të shumta. Duhet të shqyrtohen traktatet e ndryshme nga autoritetet rajonale aktualisht në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për të identifikuar rregullat që synojnë mbrojtjen specifike të të drejtave të grave.

Në kuadrin e KEDNJ-së, normat që kanë për qëllim veçanërisht mbrojtjen e të drejtave të grave janë të pakta dhe kanë të bëjnë veçanërisht me të drejtën për martesë dhe ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit. Sa i përket ndalimit të diskriminimit, KEDNJ në nenin 14 shprehet se: “*Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose sociale, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”.

Dispozita e mësipërme përmend baza të palejueshme të diskriminimit, por ato nuk janë shteruese, sepse në jurisprudencë mund të gjenden rrethana të tjera që mund të klasifikohen si “shkaqe diskriminuese”, si: orientimi seksual, statusi bashkëshortor, privimi nga liria, shtetësia, statusi financiar, mungesa e formimit, e të tjera.¹²⁵

Kështu p.sh. në rastin *Opuz k.Turqisë (2009)*¹²⁶, Gjykata e Strasburgut gjeti shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së, pasi rezultoi se dhuna në familje ishte toleruar nga autoritetet turke dhe se mjetet ankimore nuk funksiononin në mënyrë efektive. Kështu, ky qëndrim diskriminimi pasiv mbi baza gjinore nga autoritetet dhe mosndëshkimi nga gjykatat vendase, favorizonte në vijimësi dhunën në familje¹²⁷.

Po ashtu, në një çështje tjetër *D.H. dhe të Tjerë k. Republikës Çeke*¹²⁸, Gjykata e Strasburgut gjeti se kishte diskriminim në sistemin arsimor vendas ndaj fëmijëve romë, një problem ky që ndeshet edhe në vende të tjera të Europës. Me këtë vendim, Gjykata theksoi se KEDNJ-ja adreson jo vetëm akte specifike diskriminimi, por edhe praktika sistematike që ndeshen e që mohojnë gëzimin e të drejtave të njeriut për grupe etnike apo racore.

Më pas, për të forcuar dispozitat e nenit 14, Këshilli i Evropës miratoi Protokollin Nr. 12 dhe një sërë Rezolutash dhe Rekomandimesh për të parandaluar diskriminimin. Në veçanti, Protokollin Nr.12 parashikon një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit në gëzimin e të gjitha të drejtave të garantuara me ligj bazuar në parimin themelor sipas së cilit të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejta për mbrojtje të barabartë me ligj.

Parimin e mosdiskriminimit, e gjejmë të parashikuar edhe në Kushtetutën e Shqipërisë. Konkretisht, neni 18 i saj, parashikon se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht dhe pa arsye të përlegjura e objektive, për shkaqe të tilla si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

¹²⁵ Marek, A. Nowicki, *Rreth Konventës Europiane: “Komentari i shkurtër mbi Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”*, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2003, fq 381.

¹²⁶ *Opuz k.Turqisë*, Aplikimi Nr. 33401/02, Vendimi 09 Shtator 2009.

¹²⁷ Ledi Bianku&Odeta Kumbaro, “*Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*”, Botimi IV, Tiranë, 2017, f.103-105.

¹²⁸ *D.H. dhe të Tjerë k. Republikës Çeke*, Aplikimi Nr. 57325/00, {GC},Vendimi 13 Nëntor 2007.

Në kontekstin evropian, përveç KEDNJ-së, duhet të konsiderohet edhe parimi i mosdiskriminimit dhe barazia e të drejtave midis burrave dhe grave në Traktatet e Bashkimit Evropian. Sa i përket në veçanti mbrojtjes së të drejtave të grave, nën 2 TEU, duke renditur vlerat e përbashkëta për Shtetet Anëtare, mbi të cilën BE u themelua, përfshin barazinë mes grave dhe burrave, si dhe midis objektivave të ndjekura nga Bashkimi në nenin 3/3, ku është futur qëllimi i promovimit të barazisë mes grave dhe burrave.

Traktati i Lisbonës, ndër të tjera konfirmon rëndësinë e respektimit të shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut. Kështu, nëse i referohemi nenit 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian përcaktohet se Bashkimi Evropian bazohet në vlerat e respektimit të lirisë, dinjitetit të njeriut, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, duke përfshirë këtu të drejtat e personave që u përkasin pakicave, parime këto që janë të përbashkëta për Shtetet anëtare¹²⁹. Traktati i Lisbonës, në thelb të tij zhvilloi vlerat universale të të drejtave të patjetërsueshme, të padhunueshme të individit, demokracisë, barazisë, të lirisë dhe të shtetit të së drejtës. Ai zhvillon disa vlera që u përfshinë në të drejtat themelore, si mosdiskriminimi, drejtësia, solidariteti, barazia gjinore. Këto vlera të përbashkëta europiane marrin vlerë në një shoqëri ku sundon pluralizmi, mosdiskriminimi, tolerance, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave.

Nga ana tjetër, në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, në kontekstin e mbrojtjes së përgjithshme të çdo individi të parashikuar në nenin 21, është e ndaluar cdo formë e diskriminimit të bazuar në gjini¹³⁰.

Më tej, në nenin 23 të Kartës, parashikohet barazia midis grave dhe burrave. Ky nen parashikon se barazia mes burrave dhe grave garantohej në të gjitha fushat, përfshirë marrjen në punë, punën dhe shpërblimin për punën. Parimi i barazisë nuk e pengon respektimin apo miratimin e masave që parashikojnë avantazhe të veçanta për atë gjini që është më pak e përfaqësuar.

Duhet të theksohet për sa më sipër që në kontekstin rajonal evropian, si Këshilli i Evropës, si Bashkimi Evropian kanë siguruar një sistem efektiv të garancisë që gjen shprehjen e saj maksimale në të dy Gjykatat: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Jurisprudenca e tyre i jep zbatim konkret të drejtave të njeriut të njohura në traktatet e përmendura dhe më veçanërisht për të drejtat e grave ka përfaqësuar dhe përfaqëson një pikë referimi për të gjitha organet e tjera të brendshme dhe ndërkombëtare të juridiksionit, dhe është objekt i vazhdueshëm i studimit dhe analizës nga doktrina.

¹²⁹ Versioni i konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian (TBE dhe TFBE) dhe Karta e të Drejtave Themelore e BE-së, Botim i Ministrisë së Integritimit Evropian, Tiranë. www.mci-ks.net

¹³⁰ Neni 21 – “Mosdiskriminimi:

1. Ndalohet çdo lloj diskriminimi për shkaqe të tilla siç janë gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike apo sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja apo besimi, mendimet politike apo të llojeve të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, prona, lindja, aftësia e kufizuar, moshë apo orientimi seksual.

2. Brenda fushës së zbatimit të Traktateve dhe pa cenuar asnjë prej dispozitave të caktuara të tyre, ndalohet çdo diskriminim për shkak të shtetësisë”.

- **Përfundime**

Pavarësisht se pas Këshillit të Europës, shumë organizata të tjera i kthyen sytë nga të drejtat e njeriut, Këshilli i Europës ishte i pari që hodhi gurët e themelit në ngritjen e murit mbrojtës të të drejtave të njeriut dhe vendosi standartin më të lartë të arritur në fushën e njohjes, mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore u shndërrua në njësinë matëse të nivelit të demokratizimit rajonal, me ndikim të forte tek Shtetet Anëtare.

Përkundër të gjitha përpjekjeve të bëra nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian dhe megjithëse shumë progrese janë bërë në Evropë në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe profilin e barazisë gjinore nga këndvështrimi rregullator në veçanti, një barazi e plotë efektive ende nuk është materializuar në të gjitha shtetet evropiane. Shtetet duhet të përpiqen të respektojnë të drejtat dhe liritë e njeriut në përgjithësi, të zbatojnë në praktikë një politikë integruese dhe aspak diskriminuese për liritë dhe të drejtat e njeriut, si dhe të angazhohen në përmirësimin dhe avancimin e statusit të grupeve të caktuara në shoqëri, më vulnerabël.

Në të vërtetë, edhe pse gjatë dekadave shumë pabarazi ligjore janë eliminuar, jo gjithmonë gratë në Evropë gëzojnë të njëjtat mundësi që u ofrohen burrave dhe kërkesa për respektimin e të drejtave të tyre shpesh nuk pranohet. Në fakt, ato vazhdojnë të jenë objekt i formave të ndryshme të dhunës, të kufizuara në jetën politike, kanë vështirësi në pajtimin e jetës private dhe profesionale, të modeluara sipas standardeve të punës për meshkuj, shpesh shfrytëzohen në vendin e punës dhe largohen nga puna më shumë se sa burrat.

Megjithëse në Evropë, barazia midis burrit dhe gruas, përbën një parim themelor të çdo sistemi demokratik dhe ekzistojnë instrumentet ndërkombëtare dhe të brendshme të Shteteve, për mbrojtjen efektive të të drejtave të grave, barazinë e plotë midis burrave dhe grave në jetën sociale, ekonomike dhe politike, e për të cilën ka ende shumë për të bërë dhe për të arritur.

Referencat

Kushtetuta e RSH;

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ) dhe Protokollet Shtesë; www.coe.int;

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1948), www.un.org/en/universal-declaration-human-rights;

Manual për Ligjin Evropian të Mbrojtjes nga Diskriminimi, Agjensia e BE për të Drejtat Themelore të Njeriut dhe Këshilli i Evropës, Korrik 2010, marrë nga: www.echr.coe.int;

Arben Puto, “*Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut në përqasje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, Albin, Tiranë, 2002;

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, Manual për Administratën Publike, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Tiranë, Qershor, 2016;

Handbook on European data protection law, European Union Agency for Fundamental Rights & Council of Europe, 2014, Printed in Belgium, 2014;

Marek, A. Nowicki, *Rreth Konventës Europiane: “Komentari i shkurtër mbi Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”*, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2003;

Ledi Bianku & Odeta Kumbaro, *“Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut”*, Botimi IV, Tiranë, 2017;

Versioni i konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Europian (TBE dhe TFBE) dhe Karta e të Drejtave Themelore e BE-së, Botim i Ministrisë së Integrimit Europian, Tiranë. www.mei-ks.net;

Opuz k.Turqisë, Aplikimi Nr. 33401/02, Vendimi 09 Shtator 2009;

D.H. dhe të Tjerë k. Republikës Çeke, Aplikimi Nr. 57325/00, {GC}, Vendimi 13 Nëntor 2007.

ORGANIZATA E KOMBEVE TË BASHKUARA DHE IMPAKTI I SAJ NË BARAZINË GJINORE

Marinela Bogdani, studente MSH

Përmbledhje

"Barazia Gjinore" dhe "Paqja, Drejtësia dhe Institucionet e Forta" janë dy prej 17 Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara, e cila synon krijimin e një të ardhme më të mirë dhe më të qëndrueshme për të gjithë.

OKB-ja si organizata më e fuqishme ndërkombëtare ka shumë institucione nën varësinë e saj të cilat i janë dedikuar mbrojtës së të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizojë impaktin që ka pasur Organizata e Kombeve të Bashkuara në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave, që prej themelimit të saj në fund të viteve 1945 deri më sot. Për të arritur këtë qëllim në këtë punim do të shqyrtohen mënyrat e veprimit të OKB-së si dhe do të trajtohen organet dhe institucionet e Kombeve të Bashkuara të cilat janë ngarkuar me këtë përgjegjësi.

Fjalët kyçe: OKB, të drejtat e njeriut, OZHQ, barazia gjinore.

• Zhvillimi i të drejtave të njeriut.

Të drejtat e njeriut, në mënyrën që ato perceptohen në ditët e sotme, ishin fryt i krijimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Pas Luftës së Dytë Botërore, qeveritë u angazhuan për krijimin e OKB-së me qëllimin kryesor vendosjen e paqes ndërkombëtare dhe parandalimin e konfliktit, duke vendosur themelet moderne për *jus ad bellum* (të drejtën ndërkombëtare që rregullon përdorimin e forcës).

Hapi i parë për të arritur këtë qëllim ishte nënshkrimi i kartës së Kombeve të Bashkuara më 26 Qershor 1945. Preambula e të cilës pohon se objektivat kryesore të organizatës janë, ndër të tjera, për:

- Të shpëtuar brezat e ardhshëm nga goditja e luftës
- Të ripohuar besimin në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e njeriut, në të drejtat e barabarta të burrave dhe grave dhe të kombeve të mëdha dhe të vogla,¹³¹

¹³¹ Neni 1(3) i Kartës parashikon që, një nga qëllimet e OKB-së është të arrihet bashkëpunimi ndërkombëtar në 'promovimin dhe inkurajimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë, pa dallim race, gjinie, gjuhe apo feje'. Ajo çfarë Karta e OKB-së nuk e bën është që të përcaktojë përmbajtjen e çdo 'të drejte të njeriut', dhe nuk krijon as ndonjë mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Në vitin 1946, Kombet e Bashkuara krijuan Komisionin për të Drejtat e Njeriut, i cili u ngarkua me detyrën e dorëzimit të propozimeve për Kartën Ndërkombëtare të të Drejtave.¹³² Projekt Deklarata u miratua nga Asambleja e Përgjithshme në vitin 1948 dhe u njoh si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ). Ky instrument ka pasur një ndikim të thellë në zhvillimin e standarteve rajonale dhe globale për mbrojtjen e përgjithshme ose specifike të të drejtave të njeriut. Rrjedhojë e drejtpërdrejtë e DUDNJ ishte krijimi i një gjuhe universale për të drejtat e njeriut.

Që prej vitit 1948, Shtetet Anëtare vazhdimisht kanë ripërtërirë dhe ripohuar angazhimet e tyre për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në marrëveshjet ndërkombëtare. Me kalimin e viteve, rëndësia e respektimit të të drejtave të grave është ritur vazhdimisht. Organizata e Kombeve të Bashkuara për të promovuar dhe mbrojtur këto të drejta, ka themeluar institucione të cilat janë ngarkuar me këtë përgjegjësi.

• Ndikimi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Barazinë Gjinore.

Si organizata më e madhe ndërkombëtare, OKB-ja, ka pasur ndoshta ndikimin më të madh për sa i përket mbrojtjes dhe promovimit të barazisë gjinore, me organet, institucionet dhe konventat e shumta që ka themeluar. Një numër marrëveshesh kryesore udhëzojnë qeveritë dhe avokatët në promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË), e miratuar në vitin 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, shpesh përshtrohet si një ligj ndërkombëtar i të drejtave për gratë. Ajo përcakton se çfarë përbën diskriminim ndaj grave dhe krijon një agjendë për veprim kombëtar për t'i dhënë fund asaj. Vendet që kanë ratifikuar ose aderuar në këtë Konventë e kanë ligjërisht të detyruar të zbatojnë dispozitat e saj si dhe duhet të dorëzojnë raporte kombëtare së paku çdo katër vjet për masat që duhen ndërmarrë për të përmbushur detyrimet e traktatit.

Gjithashtu Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim ishin rezultat i Konferencës së Katërt Botërore mbi Gratë në Pekin të vitit 1995. Udhëheqësit botërorë u përkushtuan për masa në dymbëdhjetë fusha kritike shqetësuese, që do të zbatoheshin në bashkëpunim me sistemin e OKB-së, institucionet financiare rajonale dhe ndërkombëtare, institucionet e tjera relevante rajonale dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare, dhe gratë dhe burrat në përgjithësi.¹³³

Një nga nismat e shumta të Kombeve të Bashkuara ishte dhe miratimi i politikës së sistemit të Kombeve të Bashkuara për të gjithë sistemin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave. Politika u miratua nga Bordi Kryesor i Ekzekutivit për Koordinim në tetor të vitit 2006 dhe kishte për qëllim rritjen e vëmendjes ndaj barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në politikat dhe programet e

¹³² Komisioni u drejtua nga Eleanor Roosevelt, bashkëshortja (vejusha) e ish-presidentit. Anëtarët e Këshillit Drejtues që hartuan tekstin e DUDNJ përfshinin edhe:

- Dr Chang – Zv. Kryetar dhe filozof kinez i rrymës konfuciane
- Charles Malik – Raporter dhe filozof libanez
- René Cassin – Jurist dhe filozof francez, i cili ishte hebre dhe kishte eksperiencë personale me Holokaustin.

¹³³ <http://www.unwomen.org/en/how-we-work/intergovernmental-support/major-resolutions>

sistemit të Kombeve të Bashkuara në zbatimin e konkluzioneve të dakorduara të Këshillit Ekonomik dhe Social 1997/2.

Në vitin 2016, në sesionin e gjashtëdhjetë të tij, Komisioni për Statusin e Grave u përqendrua në lidhjet midis fuqizimit të gruas dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Theksoi urgjencën e përfshirjes sistematike të perspektivave gjinore në zbatimin e të gjithë Agjendës së 2030, të të gjitha Qëllimeve dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe në respekt të të gjitha politikave dhe programeve qeveritare në të gjitha nivelet.¹³⁴

Agjenda e 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm ka dhënë një moment shtesë dhe objektiva të qarta për Shtetet Anëtare të cilat pranuan se barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave do të jepnin një kontribut të rëndësishëm në progresin në të gjitha Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.¹³⁵

Barazia gjinore është një e drejtë themelore dhe e pacenueshme e njeriut dhe fuqizimi i grave dhe vajzave është thelbësor për të zgjeruar rritjen ekonomike dhe për të promovuar zhvillimin shoqëror.¹³⁶

• Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs), të njohura ndryshe si Qëllimet Globale, janë një thirrje universale për veprim për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur planetin dhe për të siguruar që të gjithë njerëzit të gëzojnë paqe dhe prosperitet. Këto 17 Objektiva ndërtohen mbi sukseset e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, duke përfshirë fusha të reja të tilla si ndryshimi i klimës, pabarazia ekonomike, inovacioni, konsumi i qëndrueshëm, paqja dhe drejtësia, ndër prioritetet e tjera. Qëllimet janë të ndërlidhura, shpesh çelësi i suksesit në një do të përfshijë trajtimin e çështjeve më të zakonshme të lidhura me një tjetër.

Një prej Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm është dhe arritja e barazisë gjinore. Fuqizimi i grave dhe promovimi i barazisë gjinore është thelbësor për përshpejtimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Përfundimi i të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave nuk është vetëm një e drejtë themelore e njeriut, por gjithashtu ka një efekt shumëfishues në të gjitha fushat e tjera të zhvillimit. Gjatë viteve të fundit, situata është përmirësuar vazhdimisht por ende ekzistojnë pabarazi të rëndësishme ndërmjet burrave dhe grave, të cilat besohet se do të minimizohen deri në vitin 2030.¹³⁷

Organizata e Kombeve të Bashkuara ka përcaktuar 9 objektiva dhe 14 indikatorë për SDG numër 5; barazia gjinore. Objektivat përcaktojnë qëllimet dhe indikatorët ndihmojnë në matjen e rezultateve të cilat janë parashikuar për tu realizuar. Disa prej objektivave kryesore janë "Zhdukja kudo e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe vajzave", "Zhdukja e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave në mjedise publike dhe private, duke përfshirë trafikimin, shfrytëzimin seksual dhe llojet e tjera të shfrytëzimit", "Zhdukja e të gjitha praktikave të dëmshme, të tilla si martesat e hershme dhe me detyrim të fëmijëve dhe gjymtimi gjeneral femëror" si dhe "Sigurimi i qasjes universale në shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese siç është rënë

¹³⁴ Strategy for Gender Equality and the Empowerment of Women (2018–2021), United Nations Vienna, 2018.

¹³⁵ STRATEGY FOR GENDER EQUALITY AND THE EMPOWERMENT OF WOMEN (2018–2021), UNITED NATIONS Vienna, 2018

¹³⁶ <https://sdgcompass.org/sdgs/sdg-5/>

¹³⁷ <http://www.sdgfund.org/goal-5-gender-equality>

dakord, në përputhje me Programin e Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Platformën për Veprim të Pekinit, si dhe dokumentet e rezultateve të konferencave të rishikimit të tyre".

- **Organet dhe Institucionet e OKB-së që i Dedikohen Mbrojtjes së të Drejtave të Grave**

Organet ndërqeveritare të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë Asamblenë e Përgjithshme, Këshillin e Sigurimit dhe Këshillin Ekonomik dhe Social (ECOSOC) rregullisht miratojnë rezolutat e dedikuara për çështjet e barazisë gjinore. UN Women mbështet këto organe duke ofruar këshilla të ekspertëve, informacione dhe rekomandime të politikave për çështjet e barazisë gjinore, shpesh përmes raporteve të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe duke mbështetur Shtetet Anëtare në të gjitha aspektet e punës së tyre, duke përfshirë negocimin e rezolutave.¹³⁸

- a. UN Women**

UN Women është entiteti i OKB-së i dedikuar barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave. Në të gjithë botën gratë dhe vajzat në mënyrë rutinore i mohohen qasja në arsim dhe kujdes shëndetësor; ato janë të nën-përfaqësuara në vendimmarrjen ekonomike dhe politike dhe vuajnë nga dhuna dhe diskriminimi. Një kampion global për gratë dhe vajzat, UN Women u krijua për të përshpejtuar progresin në përmbushjen e nevojave të tyre në mbarë botën.¹³⁹

Në korrik 2010, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara krijoi UN Women, Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave. Duke vepruar kështu, Shtetet Anëtare të OKB-së morën një hap historik në përshpejtimin e qëllimeve të Organizatës për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Krijimi i UN Women erdhi si pjesë e agjendës së reformës së OKB-së, duke bashkuar burimet dhe mandatet për një ndikim më të madh. Ai bashkon dhe ndërton mbi punën e rëndësishme të katër pjesëve më parë të dallueshme të sistemit të OKB-së, i cili u përqendrua ekskluzivisht në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:

1. Divizioni për Avancimin e Grave (DAW)
2. Instituti Ndërkombëtar i Kërkimeve dhe Trajnimit për Avancimin e Grave (INSTRAW)
3. Zyra e Këshilltarit Special për Çështjet Gjinore dhe Përparimin e Grave (OSAGI)
4. Fondi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë (UNIFEM)

Qëllimet kryesore të UN Women janë 3:

- Të mbështesin organet ndërqeveritare, siç është Komisioni për Statusin e Grave, në formulimin e politikave, standardeve dhe normave globale.
- Të ndihmojë shtetet anëtare për zbatimin e këtyre standardeve, të gatshëm për të ofruar mbështetje të përshtatshme teknike dhe financiare për ato vende që e kërkojnë atë dhe për të krijuar partneritete efektive me shoqërinë civile.
- Të mbajë sistemin e OKB-së përgjegjës për angazhimet e veta për barazinë gjinore, duke përfshirë monitorimin e rregullt të progresit në mbarë sistemin.

¹³⁸ <http://www.unwomen.org/en/how-we-work/intergovernmental-support/major-resolutions>

¹³⁹ <https://www.un.org/youthenvoy/2013/07/un-women-the-united-nations-entity-for-gender-equality-and-the-empowerment-of-women/>

- **Përfundimet**

Gjatë shumë dekadave, OKB-ja ka bërë përparime të konsiderueshme për të përmirësuar situatën e barazisë gjinore, duke përfshirë marrëveshje të rëndësishme për eliminimin e formave të diskriminimit ndaj grave. Barazia gjinore nuk është vetëm një e drejtë themelore e njeriut, por arritja e saj ka pasoja të mëdha socio-ekonomike pasi fuqizimi i grave nxit ekonominë e lulëzuara, duke nxitur produktivitetin dhe rritjen.

Për shumë vite, OKB është përballur me sfida serioze në përpjekjet e saj për të promovuar barazinë gjinore në nivel global bazuar në vizionin e barazisë të përcaktuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, pabarazitë gjinore mbeten thellë të rrënjësura në çdo shoqëri. Gratë ende nuk kanë qasje në punë të denjë dhe përballen me diskriminime në ambientet profesionale në shumë vende. Atyre u mohohet shumë shpesh qasja në arsimin bazë dhe kujdesi shëndetësor. Gratë në të gjitha pjesët e botës vuajnë nga dhuna dhe diskriminimi si dhe janë të nën-përfaqësuar në proceset vendimmarrëse politike dhe ekonomike.

Barazia gjinore, si dhe mbrojtja e të drejtave të grave nuk duhet të jetë vetëm qëllim i një organizate, por duhet të jetë qëllim i çdo personi në botë.

“Arritja e barazisë gjinore kërkon angazhimin e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve. Është përgjegjësi e të gjithëve” - Ban Ki-moon.

Referencat

Strategy for Gender Equality and the Empowerment of Women (2018–2021), United Nations Vienna, 2018;

Women's Rights are Human Rights, United Nations New York and Geneva, 2014;

Sandra Whitworth, *Men, Militarism, and UN Peacekeeping: A Gendered Analysis*, Lynne Rienner Publisher, 2004;

Forsythe.D.P, *Human Rights in International Relations*, Cambridge University Press, 2006;

Hyseni F. dhe Haliti B, *Mbrojtja e Lirive dhe të drejtave të njeriut- element themelor në funksionimin e shtetit modern*, Telegrafi: <https://telegrafi.com/mbrojtja-e-lirive-dhe-te-drejtave-te-njeriut-element-themelor-ne-funksionimin-e-shtetit-modern/>

Armstrong D, Lloyd L, Redmond J, *Organizatat Ndërkombëtare në Politikën Botërore*, Tirana Times, 2009;

<http://www.sdgfund.org/goal-5-gender-equality>

<http://www.unwomen.org/en/how-we-work/intergovernmental-support/major-resolutions>

<https://www.un.org/youthenvoy/2013/07/un-women-the-united-nations-entity-for-gender-equality-and-the-empowerment-of-women/>

RËNDËSIA E BARAZISË GJINORE DHE ROLI I SAJ SI FAKTOR STABILITETI

Oltian Gorezi, student MSH
Denada Seferi, studente MSH

Përmbledhje

Që nga shfaqja e qenieve njerëzore në tokë, ndryshimet fizike dhe aftësitë kanë luajtur një rol të rëndësishëm për sa i përket dallimit ndërmjet burrave dhe grave. Për shkak të forcës së tyre më të madhe fizike, burrat zakonisht ishin përgjegjës për gjuetinë dhe aktivitete të tjera në natyrë, të cilat kërkonin më shumë forcë. Nga ana tjetër gratë, të cilat konsideroheshin me aftësi fizike më të dobëta e për rrjedhojë ishin përgjegjëse për detyra më pak fizike, të tilla si kujdesi për familjen apo rritja e fëmijëve¹⁴⁰. Gjatë shekujve, rolet mashkullore dhe femërore janë bërë më të standardizuara.

Sot, burrat dhe gratë priten të ndjekin sjellje të caktuara që konsiderohen specifike sipas gjinisë. Në shoqëritë e sotme të ndërlidhura, rolet dhe sjelljet e ndara sipas gjinsë duken më të unifikuara globalisht. Rolet gjinore konsiderohen nga studiuesit si konstrukte shoqërore që fillojnë që në lindje¹⁴¹.

Ajo që vihet re është një shkallë nënvlerësimi ndaj femrave, e cila ndryshon në varësi të vendeve dhe zhvillimit të tyre.

Në rastin e Bashkimit Evropian, ligjet e bëjnë të detyrueshme trajtimin e barabartë midis burrave dhe grave në të gjitha aspektet e jetës. Megjithatë, përkundër ilegalitetit të diskriminimit gjinor, trajtimi i pabarabartë ndaj grave mbart shumë aspekte të jetës shoqërore dhe duhet adresuar me masa shumëplanëshe, referuar edhe marrëveshjeve ndërkombëtare në këtë fushë.

Fjalët kyçe: barazia gjinore, OKB, drejtësi sociale, strategji gjinore, zhvillim i qëndrueshëm, të drejta të njeriut.

• Barazia gjinore

Barazia gjinore, barazia midis burrave dhe grave, nënkupton konceptin se të gjitha qeniet njerëzore, si burrat ashtu edhe gratë, janë të lira të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa kufizimet e vendosura nga stereotipet, rolet e ngurta gjinore dhe paragjykimet. Barazia gjinore nënkupton që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e grave dhe burrave konsiderohen, vlerësohen dhe favorizohen njësoj. Kjo nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të

¹⁴⁰ Alice H. Eagly, *Sex differences in social behavior: A social-role interpretation* Hillsdale, New Jersey, Laurence Erlbaum, 1987

¹⁴¹ Eagly, A. H., Wood, W., & Diekmann, A. B. (2000). Social role theory of sex differences and similarities: A current appraisal. In T. Eckes, & H. M. Trautner (Eds.), *The developmental social psychology of gender* Mahwah, New Jersey: Erlbaum.

drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse ata kanë lindur mashkull apo femër. Barazia gjinore nënkupton drejtësinë e trajtimit për gratë dhe burrat, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet ekuivalent në aspektin e të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive.¹⁴²

Pa paqe, drejtësi, stabilitet, të drejta njerëzore dhe qeverisje efektive të bazuar në sundimin e ligjit, nuk mund të shpresojmë për zhvillim të qëndrueshëm. Jetojmë në një botë ku gjithnjë e më shumë po krijohen ndasi. Disa rajone gëzojnë nivele të qëndrueshme të paqes, sigurisë dhe prosperitetit, ndërsa të tjerët bien në cikle të pafundme të konfliktit dhe dhunës.

Nivelet e larta të dhunës së armatosur dhe pasigurisë kanë një ndikim shkatërrues në zhvillimin e një vendi, duke ndikuar në rritjen ekonomike dhe shpesh duke rezultuar në ankesa të gjata që mund të zgjasin për breza. Dhuna seksuale, krimi, shfrytëzimi dhe tortura janë gjithashtu të përhapura në rastet kur ka konflikte ose nuk ka sundim të ligjit dhe vendet nuk marrin masa për të mbrojtur ata që janë më në rrezik.

Duhet marrë masa për reduktimin e të gjitha formave të dhunës dhe duhet punuar me qeveritë dhe komunitetet për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për konfliktet dhe pasigurinë¹⁴³. Forcimi i sundimit të ligjit dhe promovimi i të drejtave të njeriut është vendimtar për këtë proces, siç është reduktimi i përdorimit të armëve të paligjshme dhe forcimi i pjesëmarrjes së vendeve në zhvillim në institucionet e qeverisjes globale.

Kombet e Bashkuara në Strategjinë e Barazisë Gjinore 2018-2021, theksojnë barazinë gjinore si një "të drejtë themelore njerëzore dhe një bazë të domosdoshme për një botë paqësore, të begatë dhe të qëndrueshme" si dhe nevoja për të përshpejtuar fuqizimin e grave nëpërmjet ndërhyrjeve për të bërë transformimet strukturore të nevojshme për arritjen e barazisë gjinore përmes katër fushave prioritare si:

- Heqja e barrierave strukturore në fuqizimin ekonomik të grave;
- Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës me bazë gjinore;
- Promovimi i pjesëmarrjes dhe lidhshmërisë të grave në të gjitha format e vendimmarrjes;
- Forcimi i strategjive të përgjegjësisë gjinore në lidhje me krizat, konfliktet dhe parandalimin e katastrofave, gatishmërisë dhe rimëkëmbjes.

Për shembull, për të arritur fuqizimin ekonomik të grave rekomandot sigurimi i të drejtave të barabarta të grave ndaj pronës, kredisë, tokës dhe burimeve natyrore, punës së denjë dhe aksesit të barabartë në shërbimet themelore duke përfshirë kujdesin shëndetësor. Përpjekje të tilla do të nxitnin progres në të gjitha fushat, duke përfshirë mirëqenie më të mirë, shëndet, arsim cilësor, punë dinjitoze, rritje ekonomike si dhe reduktimin e pabarazisë.

• Rëndësia e barazisë gjinore

Barazia gjinore është thelbësishme e lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm dhe është jetësore për realizimin e të drejtave të njeriut për të gjithë. Objektivi i përgjithshëm i barazisë gjinore është një shoqëri në të cilën gratë dhe burrat gëzojnë të njëjtat mundësi, të drejta dhe detyrime në të gjitha

¹⁴² ABC Of Women Worker's Rights And Gender Equality, ILO, 2000. p. 48.

¹⁴³ Eagly, A. H., Wood, W., & Diekmann, A. B. (2000). Social role theory of sex differences and similarities: A current appraisal. In T. Eckes, & H. M. Trautner (Eds.), *The developmental social psychology of gender* Mahwah, New Jersey: Erlbaum.


sferat e jetës. Barazia ndërmjet burrave dhe grave ekziston kur të dyja gjinitë janë në gjendje të ndajnë njëlloj shpërndarjen e fuqisë dhe ndikimit; të kenë mundësi të barabarta për pavarësi financiare nëpërmjet punës ose përmes krijimit të bizneseve; gëzojnë qasje të barabartë në arsim dhe mundësi për të zhvilluar ambicie personale, interesa dhe talente; ndajnë përgjegjësinë për shtëpinë dhe fëmijët dhe janë tërësisht të lirë nga detyrimi, frikësimi dhe dhuna me bazë gjinore, si në punë ashtu edhe në shtëpi.

Sidoqoftë, është e rëndësishme të pranojmë se aty ku ekziston pabarazia gjinore, në përgjithësi gratë janë të përjashtuara ose të pafavorizuara në lidhje me vendimmarrjen dhe qasjen në burimet ekonomike dhe sociale. Prandaj, një aspekt kritik i promovimit të barazisë gjinore është fuqizimi i grave, me fokus në identifikimin dhe korrigjimin e pabarazive të pushtetit dhe dhënien e më shumë autonomie grave për të menaxhuar jetën e tyre. Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk do të thotë që burrat dhe gratë të bëhen të njëjtë; vetëm se qasja në mundësitë dhe ndryshimet e jetës të mos jenë të ndikuara nga gjinia e tyre.

- **Roli i barazisë gjinore si faktor stabiliteti**

Mundet barazia gjinore të luajë një rol kyç në parandalimin e konflikteve të dhunshëm? Barazia gjinore është një faktor thelbësor në sigurinë dhe stabilitetin e një vendi. Përfshirja e grave nga pjesëmarrja aktive në shoqëri mund të rrisë rrezikun e paqëndrueshmërisë. Barazia gjinore nuk është vetëm për të bërë atë që është e drejtë apo për drejtësinë sociale; ajo është gjithashtu një element i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe një parashikues kritik i stabilitetit dhe sigurisë, dhe në parandalimin e konflikteve.

Hulumtimi mbi gratë, paqen dhe sigurinë janë dëshmi të forta se fuqizimi i grave dhe barazia gjinore shoqërohen me rezultate më paqësore dhe të qëndrueshme.

Figura 1: Roli i barazisë gjinore në stabilitetin e shtetit

Burimi: Crespo-Sancho, C. 2017. "The Role of Gender in the Prevention of Violent Conflict." Pathways for Peace: Inclusive Approaches to Preventing Violent Conflict. World Bank, Washington, DC

Dhuna ndaj grave është një parashikues nëse një shoqëri përgjithësisht është e prirur për konflikte të dhunshme a jo.

Sa më i madh boshllëku gjinor (i definuar si dallimet në përvojat dhe mundësitë midis burrave dhe grave), aq më shumë ka gjasë që një vend të përfshihet në konfliktet ndërkombëtare dhe të brendshme dhe të përdorë dhunën si përgjigje.

Sa më i lartë të jetë niveli i dhunës ndaj grave, aq më shumë ka gjasë që një vend mund të mos jetë duke vepruar në përputhje me normat dhe traktatet ndërkombëtare.

Barazia më e lartë gjinore korrespondon me mundësi më të ulta të një vendi për të përdorur forcën ushtarake për të zgjidhur mosmarrëveshjet me vendet e tjera. Ashpërsia e dhunës së përdorur në konfliktet ndërkombëtare zvogëlohet me barazi gjinore më të lartë.

Vendet me standarde të ulëta të të drejtave të njeriut, duke përfshirë standarde të ulëta në lidhje me barazinë gjinore, kanë më shumë gjasa të kenë mosmarrëveshje ndërshtetërore të militarizuara dhe të dhunshme ndërshtetërore.

Një faktor i rëndësishëm në lidhje me barazinë gjinore për sigurinë dhe zhvillimin është pjesëmarrja e grave në pozita pushteti, duke përfshirë politikën, diskutimet e paqes dhe negociatat. Rezoluta e OKB-së 1325 njeh rëndësinë e rolit të grave në parandalimin dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Sipas Studimit Global të OKB 1325 ¹⁴⁴ (United Nations Security Council resolution) forcimi i barazisë gjinore dhe të drejtave të grave është njëkohësisht detyrim për të drejtat e njeriut dhe gjithashtu çelësi për kultivimin e paqes. Gjithashtu u kërkohej shteteve të sigurojnë përfaqësim

¹⁴⁴ *The Global Study on the Implementation of the UNSC Resolution 1325*, UN Women, (2015).

më të madh të grave në të gjitha nivelet vendimmarrëse në institucionet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe në mekanizmat për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve¹⁴⁵.

Ekziston një lidhje pozitive midis pjesëmarrjes së grupeve të grave dhe rezultateve të marrëveshjes së paqes. Kur gratë janë më pak të përfshira, marrëveshjet arrihen më rrallë dhe gjasat për arritjen e një marrëveshjeje janë edhe më të ulëta kur grupet e grave nuk janë të përfshira.

- *Disa fakte dhe shifra të dala nga studimi:*

- 10 vendet me numrin më të lartë të vdekshmërinë amtare janë të gjitha ose në konflikt ose vende pas konfliktit (UN Women, 194).
- Pjesëmarrja e grave rrit probabilitetin e një marrëveshjeje paqeje që zgjat të paktën dy vjet me 20 % dhe me 35 % probabilitetin e një marrëveshjeje paqësore që zgjat 15 vjet (UN Women, 41-42)
- Marrëveshjet e paqes kanë 64 % më pak të ngjarë të dështojnë kur përfaqësuesit e shoqërisë civile marrin pjesë (UN Women, 42)
- Në 2012-13, vetëm 6 % e të gjithë ndihmës ndaj shteteve dhe ekonomive të brishta synonin barazinë gjinore si objektiv kryesor; vetëm 2 % e ndihmës për paqen dhe sigurinë synonin barazinë gjinore si një objektiv kryesor (UN Women, 373)
- Vetëm 15 (24 %) nga 62 subjekte të Kombeve të Bashkuara që raportonin të dhënat në vitin 2015 kishin sisteme për të ndjekur resurset e lidhura me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave (UN Women, 379).


• ***Barazia gjinore ekonomike***

Fuqizimi ekonomik i grave ka një efekt shumëfishues në mirëqenien lokale dhe kombëtare të një vendi. Fuqizimi i grave dhe promovimi i barazisë gjinore është thelbësor për përsheptimin e zhvillimit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të cilat janë elementë të rëndësishëm në parandalimin e konflikteve të dhunshme.

Disa nga gjetjet e hulumtimit lidhur me barazinë ekonomike gjinore përfshijnë:

- Shtetet me pjesëmarrje më të lartë të femrave në fuqinë punëtore shfaqin nivele më të ulëta të dhunës ndërkombëtare dhe kanë më pak gjasa të përdorin forcën ushtarake për të zgjidhur konfliktet ndërkombëtare.
- Vendet me 10 përqind të grave në fuqinë punëtore në krahasim me vendet me 40 përqind të femrave në fuqinë punëtore gati 30 herë kanë më shumë gjasa të përjetojnë konflikte të brendshme

¹⁴⁵ Financing for the Implementation of National Action Plans on UN Security Council Resolution 1325: Critical for Advancing Women's Human Rights, Peace and Security (2014).

Figura 2: Barazia gjinore ekonomike dhe dhuna ndërkombëtare

Burimi: Caprioli, M. 2000. "Gendered Conflict." Journal of Peace Research

Nëse burrat dhe gratë marrin pjesë në mënyrë të barabartë në ekonomi, rezultatet do të shtonin deri në 28 trilionë dollarë, ose 26 %, në GDP globale vjetore deri në vitin 2025. Prova është e qartë: Duke pasur një shoqëri me më shumë barazi gjinore do të kemi edhe shtete më paqësorë e të qëndrueshëm.

Barazia gjinore është parashikuesi numër një i paqes - më shumë sesa pasuria e një shteti apo niveli i demokracisë ¹⁴⁶.

• Përfundime

Ekzistojnë dallime midis roleve të burrave dhe grave, dallime që kërkojnë qasje të ndryshme. Ka pabarazi sistematike midis burrave dhe grave. Ekzistojnë modele të qarta të qasjes inferiore të grave ndaj burimeve dhe mundësive. Për më tepër, gratë janë sistematikisht të nën-përfaqësuara në proceset vendimmarrëse që formojnë shoqëritë e tyre dhe jetën e tyre. Ky model i pabarazisë është një pengesë për përparimin e çdo shoqërie, sepse kufizon mundësitë e gjysmës së popullsisë së saj. Kur gratë janë të kufizuara për të arritur potencialin e tyre të plotë, ky potencial sjell humbje për shoqërinë në tërësi. Është i nevojshëm hartimi dhe zbatimi i programeve, që do të përpiqen të adresojnë këto problematika dhe të merren hapa të mëtejshëm për arritjen e barazisë gjinore.

Arritja e barazisë gjinore nënkupton ndryshime për burrat dhe gratë. Marrëdhënie më të barabarta duhet të bazohen në një ripërcaktim të të drejtave dhe përgjegjësisë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës, duke përfshirë familjen, vendin e punës dhe shoqërinë në përgjithësi.

¹⁴⁶ Hudson, Valerie et al. (2014), *Sex & World Politics*, Columbia University Press.

Barazia gjinore është thelbësisht e lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm dhe është jetësore për realizimin e të drejtave të njeriut për të gjithë. Forcimi i barazisë gjinore dhe të drejtave të grave është njëkohësisht detyrim për të drejtat e njeriut dhe gjithashtu çelësi për kultivimin e paqes. Barazia gjinore është një faktor thelbësor në sigurinë dhe stabilitetin e një vendi. Përrjashtimi i grave nga pjesëmarrja aktive në shoqëri mund të rrisë rrezikun e paqëndrueshmërisë. Barazia gjinore nuk është vetëm për të bërë atë që është e drejtë apo për drejtësinë sociale; ajo është gjithashtu një element i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe një parashikues kritik i stabilitetit dhe sigurisë, dhe në parandalimin e konflikteve.

Referencat

- Alice H. Eagly, (1987) *Sex differences in social behavior: A social-role interpretation* Hillsdale, New Jersey, Laurence Erlbaum;
- Eagly, A. H., Wood, W., & Diekmann, A. B. (2000). Social role theory of sex differences and similarities: A current appraisal, in T. Eckes, & H. M. Trautner (Eds.), *The developmental social psychology of gender* Mahwah, New Jersey: Erlbaum;
- ABC Of Women Worker's Rights And Gender Equality, ILO, 2000;
- The Global Study on the Implementation of the UNSC Resolution 1325 (UN Women) (2015);
- Hudson, Valerie et al. (2014), *Sex & World Politics*. Columbia University Press;
- Financing for the Implementation of National Action Plans on UN Security Council Resolution 1325: Critical for Advancing Women's Human Rights, Peace and Security (2014);
- Integrating Gender into the New Deal for Engagement in Fragile States (2012);
- Nexus Brief: How to Apply a Human Rights Framework to Macroeconomic Strategies (2012);
- Crespo-Sancho, C. "The Role of Gender in the Prevention of Violent Conflict." *Pathways for Peace: Inclusive Approaches to Preventing Violent Conflict*. World Bank, Washington, DC. (2017);
- Caprioli, M. "Gendered Conflict." *Journal of Peace Research* (2000).

Të drejtat e autorit 2019 © Qendra ACT for SOCIETY



Publikimi
Qendra ACT for SOCIETY
Rruga "Blv. Zhanë D'ark" Nd.61, H.5, Ap.24
Tel: +355 44507447
Web: www.actforsocietycenter.org